



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 46

Tiranë – E enjte, 4 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 28.3.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018..... 3689
Rezolutë e Kuvendit datë 28.3.2019	Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve” për vitin 2018 dhe për Planin e Veprimit për vitin 2019..... 3691
Dekret i Presidentit nr. 11149, datë 25.3.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3693
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 27.3.2019	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Brendshme dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të sipërfaqeve 77 m ² e 125 m ² , dhe për një ndryshim në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1691, datë 10.10.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe nënprefektët, administratën e tyre, për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorinë e PMNZSH-së)”, të ndryshuar, dhe nr. 448, datë 16.6.2005, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”..... 3694
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 27.3.2019	Për dhënien në përdorim Partisë Republikane, si seli, të disa mjediseve të godinës katërkatëshe, ish-shtëpia botuese e librit shkollor “8 Nëntori”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë..... 3697
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 27.3.2019	Për dhënien në përdorim Partisë Demokratike, si seli, të disa mjediseve të godinës katërkatëshe, ish-shtëpia botuese e librit shkollor “8 Nëntori”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë 3700

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 169, datë 27.3.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 16, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	3703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 170, datë 27.3.2019	Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”.....	3705
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019	Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.....	3707
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2, datë 2.4.2019	Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.....	3720
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 5, datë 2.4.2019	Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	3722
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 90, datë 2.4.2019	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	3745



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e veçantë të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), si institucion i pavarur dhe përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e së drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe për nxitjen e standardeve më të larta në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që ka në thelb të fushës së veprimtarisë së tij;

- Duke njohur zhvillimin pozitiv që po merr ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe duke inkurajuar e mbështetur këtë institucion në rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve publike dhe kontrolluesve publikë e privatë për detyrimet e tyre mbi transparencën dhe llogaridhënien, në kuadër të së drejtës për informim, por edhe të ruajtjes së jetës private, si dhe duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

- Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni në arenën ndërkombëtare dhe duke vlerësuar, në këtë aspekt, zgjedhjen e Zyrës së Komisionerit në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë ICDPPC, si dhe konfirmimin e tij si anëtar vëzhgues në Bordin Europian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në formatin e tij të ri si organ vendimmarrës i Bashkimit Europian, në kuadër të Rregullores 2016/679 të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR);

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018 dhe konstaton se:

- Veprimtaria e Komisionerit, ka shënuar përmirësim të ndjeshëm në zbatimin e ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; ligjin nr.

9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

- Në kuadër të së drejtës për informim, ka vijuar punën për përmirësimin e procedurave për shqyrtimin e ankesave, si dhe nxitjen e autoriteteve publike për të vënë në dispozicion të publikut informacion pa kërkesë.

- Niveli i transparencës në institucionet qendrore dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore është përmirësuar në krahësim me vitin 2017.

- Është miratuar programi “Model i transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i cili do të vihet në zbatim gjatë vitit në vazhdim nga organet e vetëqeverisjes vendore.

- Objekti i ankesave të adresuara pranë Zyrës së Komisionerit lidhet kryesisht me:

Cenimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (e drejta për akses, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit të marrë informacion nga kontrolluesi lidhur me përpunimin e të dhënave të tij); përhapjen/transmetimin e të dhënave personale pa pëlqimin e subjektit të të dhënave personale, si dhe në persona të paautorizuar, për të mbrojtur të dhënat personale; përpunimi i të dhënave në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme (përhapja në mediat dhe portalet online); vendosjes së kamerave në ambiente publike dhe private; marketingut të drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkua, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike; tejkalimi i afatit të mbledhjes së të dhënave personale për një qëllim të caktuar.

- Numri i hetimeve proaktive me iniciativë është rritur lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve nga kompanitë e mëdha publike dhe private.

- Është monitoruar zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri, si dhe janë ndërmarrë hetime administrative në kuadër të verifikimeve të zbatimit të tyre.

- Është angazhuar në monitorimin e përpunimit të të dhënave personale dhe mbikëqyrjen e respektimit të masave të sigurisë gjatë përpunimit të tyre, nga kontrollues publik dhe privatë;

- Ka adresuar rekomandime pas çdo kontrolli të ushtruar në kontrollues dhe përpunues të ndryshëm publikë dhe privatë.

- Vazhdon të jetë e ulët ndjeshmëria dhe angazhimi qytetar, lidhur me zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.



Gjatë vitit 2018 janë trajtuar vetëm 3 ankesa, në të cilat ankuesit kanë pretenduar në moskonsultimin e projektakteve me publikun.

- Në zbatim të VKM-së nr.145, datë 13.3.2018, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit’”, konstatohet se ky regjister është instaluar në 27 autoritete publike, duke u shoqëruar me trajnime për koordinatorët dhe stafin IT të këtyre institucioneve.

- Është organizuar edicioni i 28-të i Konferencës së Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, i cili u zhvillua për herë të parë në Shqipëri, ku morën pjesë rreth 100 përfaqësues të 62 autoriteteve evropiane të mbrojtjes së të dhënave.

- Është angazhuar në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ka luajtur rol proaktiv në kuadër të implementimit të akteve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

- Ka dhënë mendime për projektligje dhe akte nënligjore, në rastet e kërkuara, me synim harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Ka tendencë në rritje në lidhje me numrin e hetimeve pranë kontrolluesve të ndryshëm me sensibilitet, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale si: institucione financiare, mbledhjes së borxhit, telekomunikacion, media online etj. Gjithashtu, vlejné të përmenden hetimet administrative të ndërmarra pranë disa ministrive.

- Është angazhuar në organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjëse për respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Aktivitetet janë fokusuar kryesisht në sistemin arsimor, duke përfshirë nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, studentë dhe staf akademik, koordinatore të së drejtës për informim, shoqërinë civile, median, kontrollues publikë dhe privatë në sektorin shëndetësor, si dhe sektorin bankar.

- Ka zhvilluar trajnime të ndryshme me objekt të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, por vihet re se kategori të caktuara të autoriteteve publike nevojiten të përfshihen në trajnimet e planifikuara në të ardhmen, ku veçojmë gjykatat, bashkitë dhe shoqëritë shtetërore.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit, për vitin 2019, në përmbushje të

detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

- Të thellojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, mbi planin tematik, duke synuar rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesin në informacion.

- Të monitorojë përditësimin e programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, nga autoritetet publike, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit vendor.

- Të investohet për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, që administrohet nga autoritetet publike.

- Të zhvillohet mbi plan tematik procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke synuar minimizimin e shkeljeve të ligjit, respektimin e privatësisë dhe përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale.

- Të mbikëqyrë kontrolluesit publikë dhe privatë mbi zbatimin e detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave, në lidhje me të drejtat e tyre, qëllimin e përpunimit, publikimin e politikave të privatësisë në faqet e tyre *online*.

- Të rrisë numrin e masave administrative për shkelje ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

- Të përfshihet për të pasur rol aktiv në rregullimin e veprimtarisë së medias *online*, duke siguruar informacion publik proaktiv nga autoritetet publike, në respekt dhe garantim të parimeve dhe legjislacionit për privatësinë.

- Të forcojë marrëdhëniet bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e dy fushave të veprimtarisë së institucionit dhe organizimin e trajnimeve.

- Të vijojë të luajë rol aktiv në favor të proceseve integruese të vendit, në përmbushje të funksionit të anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë ICDPPC, si dhe atij të vëzhguesit në Bordin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.



- Të asistojë në hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor, me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me legjislacionin përkatës të BE-së, konkretisht me rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale) dhe direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (direktiva për mbrojtjen e të dhënave të personave fizikë gjatë procesit penal).

- Të intensifikojë dhe të nxisë punën në përmbushjen e plotë të detyrimeve ndërkombëtare mbi ratifikimin dhe nënshkrimin e protokollit shtesë të Konventës 108+ “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”.

- Të vijojë aktivitetet informuese e sensibilizuese mbi edukimin e të rinjve për të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale.

Miraturar më 28.3.2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË GRUPIT TË DEPUTETËVE “MIQTË E FËMIJËVE” PËR VITIN 2018 DHE PËR PLANIN E VEPRIMIT PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar angazhimin e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” (GDMF) në advokimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në marrjen e nismave ligjore dhe hartimin e politikave efektive për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe në forcimin e kontrollit parlamentar për realizimin e këtyre të drejtave;

- Duke mbështetur GDMF-në për angazhimin në mbrojtjen dhe fuqizimin e fëmijëve e të rinjve në Shqipëri; qasjen proaktive për ta vendosur interesin më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve në qendër të vëmendjes gjatë diskutimit dhe miratimit të ligjeve, politikave dhe programeve kombëtare në Shqipëri dhe për ndërmarrjen e nismave në nivel vendor e kombëtar, rajonal e ndërkombëtar për përparimin e të drejtave të fëmijëve, sikurse është pasqyruar edhe në raportin vjetor të GDMF-së për vitin 2018;

- Duke konsideruar bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë për fëmijët, si edhe dialogun me vetë fëmijët, si një element thelbësor në kapërcimin e sfidave të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e gjithë masave të nevojshme për sigurimin e një klime mbështetëse për fëmijët në Kuvendin e Shqipërisë;

Pas shqyrtimit të raportit vjetor të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2018:

- GDMF-ja ka zhvilluar në vazhdimësi aktivitete, takime dhe sesione informuese me fëmijë dhe të rinj nga i gjithë vendi, me qëllim krijimin e një klime mbështetëse për fëmijët në Kuvendin e Shqipërisë dhe evidentimin e problematikave konkrete që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Kuvendi i Shqipërisë ka mirëpritur 12 700 fëmijë.

- Është rritur niveli i kontrollit parlamentar të ushtruar ndaj institucioneve kushtetuese ose të krijuara me ligj dhe agjencive publike që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet realizimit të seancave dëgjimore dhe takimeve të komiteteve të GDMF-së me partnerët dhe bashkëpunëtorët.

- Krahas angazhimit në veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të GDMF-së, deputetët, anëtarë të tij, kanë marrë pjesë aktive në mbledhjet që komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar për çështjet e fëmijëve. Gjatë vitit 2018, komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar 18 seanca, në të cilat janë shqyrtuar, diskutuar/miraturuar projektligje, të cilat prekin çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve, si dhe janë dëgjuar raportime të ministrave, të përfaqësuesve të ministrive, institucioneve në varësi dhe institucioneve të krijuara me ligj.

- Deputetë të GDMF-së ndërmorën nismën ligjore për adresimin e problemeve që kishin të bënin me regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile. Propozimi i deputetëve u hartua në bashkëpunim me UNICEF-in, UNHCR-në, ekspertë të pavarur dhe në konsultim me shoqërinë civile. Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 69/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 ‘Për gjendjen civile’”.

- GDMF-ja bashkëpunon me institucione të administratës publike, institucionet e pavarura të të



drejtave të njeriut, partnerë ndërkombëtarë, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të botës akademike, biznesin, median, grupet e fëmijëve dhe të rinjve dhe çdo të interesuar në fushën e të drejtave të fëmijëve. Falë bashkëpunimit me këta aktorë, veçanërisht me fëmijët, është rritur ndjeshmëria publike në evidentimin dhe adresimin e problematikave konkrete që prekin gëzimin e të drejtave të fëmijëve.

- GDMF-ja organizoi dëgjesa, me qëllim prezantimin e raporteve të hartuara prej fëmijëve dhe të rinjve nga bashki të ndryshme mbi nivelin e respektimit dhe gëzimit të të drejtave të tyre, sidomos nga institucionet shtetërore dhe për rolin që luan pjesëmarrja e fëmijëve në vendimarrjen publike.

- Komitetet e GDMF-së u konstituuan, duke bërë një rishpërndarje të deputetëve në to, si nevojë e reflektimit të shtimit të numrit të deputetëve-anëtarë të GDMF-së.

- GDMF-ja rishikoi dhe miratoi rregulloren e vet të brendshme, si dhe Planin Strategjik të Veprimit (2018–2021).

- GDMF-ja vijoi veprimtarinë për avancimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon GDMF-së, për vitin 2019, të përqendrohet në këto drejtime:

1. Angazhimin, në bashkëpunim me komisionet e përhershme parlamentare, në shqyrtimin e nismave që mundësojnë përmirësimin e mirëqenies dhe shëndetin e çdo fëmije, mes të cilave dhe projektligjin “Për ndihmën ekonomike”, dhe përmirësimet ligjore për sa i takon jodizimit të kripës dhe ndikimit në shëndetin e fëmijëve, sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit të Shqipërisë.

2. Analizimin e kalendarit të nismave ligjore të Qeverisë me fokus ligjet/nismat ligjore me ndikim në të drejtat e fëmijëve brenda muajit qershor 2019.

3. Mbikëqyrjen mes formave të kontrollit parlamentar të zbatimit të ndryshimeve të miratuara në ligjin “Për gjendjen civile” në vijimësi.

4. Diskutimin e raportit zyrtar të Republikës së Shqipërisë për të drejtat e fëmijës, përpara dorëzimit pranë Komitetit të Konventës së Kombeve të Bashkuara, si dhe vlerësimin për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo konventë dhe nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm lidhur me fëmijët dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit për të

Drejtat e Fëmijëve në mënyrë sistematike, brenda muajit prill 2019.

5. Ndjekjen, në bashkëpunim me komisionet e përhershme parlamentare, të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për çështje të të drejtave të fëmijëve, si dhe realizimin e të paktën një dëgjese publike me këto institucione për fuqizimin e rolit të tyre dhe përmirësimin e respektimit e garantimit të të drejtave të fëmijëve.

6. Realizimin e dëgjesave me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për deinstitutionalizimin e fëmijëve, sigurimin e familjeve alternative dhe përmirësimin e procedurës së birësimit, duke përfshirë opinionin e fëmijëve, si dhe për zbatimin dhe buxhetimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

7. Monitorimin në vazhdimësi të ecurisë së reformës së drejtësisë për të mitur.

8. Tërheqjen e mendimit të fëmijëve dhe adoleshentëve përmes forumeve dhe grupeve të tyre rajonale.

Kuvendi i Shqipërisë u kërkon institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për vitin 2019, të përqendrohen në këto drejtime:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) të vazhdojë punën mbi hartëzimin e shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të kujdesit social për fëmijë në nivel kombëtar dhe buxhetimin e tyre progresiv. MSHMS-ja të informojë GDMF-në jo më vonë se muaji shtator 2019 për ecurinë e punës.

2. MSHMS-ja të përfundojë reformën e deinstitutionalizimit të fëmijëve, si dhe të marrë masa për gjetjen dhe mbështetjen e familjeve të origjinës ose alternative, si dhe të lehtësojë procedurat e birësimit, duke marrë parasysh opinionin dhe interesin më të lartë të fëmijëve. MSHMS-ja të informojë GDMF-në jo më vonë se muaji shtator 2019 për ecurinë e zbatimit të kësaj reforme.

3. Në zbatim të Konventës për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK), MSHMS-ja të sigurojë mosdiskriminimin dhe sigurimin e aksesit në shërbime, sidomos aksesin fizik në institucione publike dhe private, aksesin në transportin publik, sigurimin e informacionit online të aksesueshëm



për fëmijët me aftësi të kufizuara. MSHMS-ja të informojë GDMF-në në muajin shtator 2019 dhe në muajin dhjetor 2019 lidhur me ecurinë e aksesueshmërisë fizike në ndërtesat e institucioneve publike dhe jopublike.

4. Për të mundësuar arsimin gjithëpërfshirës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) të rrisë numrin e mësuesve mbështetës dhe të vazhdojë trajnimin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin për vitin arsimor 2019-2020. MASR-ja të informojë GDMF-në jo më vonë se data 15 shtator 2019 lidhur me përmbushjen e këtij rekomandimi.

5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) të udhëheqë dhe të realizojë analiza të plota sektoriale, me qëllim parashikimet e nevojshme buxhetore për të mbështetur politikat dhe shërbimet për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Projektbuxheti për vitin 2020 të përmbajë tregues konkretë të buxhetit për politika dhe shërbime për fëmijët. Projektbuxheti për shërbimet për fëmijët të konsultohet me organizatat e shoqërisë civile para dërgimit për miratim në Kuvend. Projektbuxheti i vitit 2020 të shoqërohet me një raport të rekomandimeve të adresuara dhe atyre të paadresuara.

6. MFE-ja të ndjekë me përparësi trajnimin profesional dhe ofrimin e mundësive të përshtatshme për punësim të adoleshentëve dhe të rinjve. MFE-ja të informojë GDMF-në jo më vonë se muaji nëntor 2019 për ecurinë e përmbushjes së këtij rekomandimi.

7. Ministria e Drejtësisë (MD) të sigurojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë penale për të mitur dhe ndihmës ligjore të garantuar nga shteti, të trajnojë personelin në institucionet e varësisë dhe të krijojë bazën e të dhënave për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin. Jo më vonë se muaji shtator 2019, MD-ja të informojë GDMF-në për ecurinë e përmbushjes së këtij angazhimi.

8. Organet e sistemit të drejtësisë, përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e hartës së re gjyqësore, të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e hartës së re gjyqësore, me synim ngritjen e seksioneve ose specializimin e magjistratëve për të mitur në çdo juridiksion. Jo më vonë se muaji shtator 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të informojnë GDMF-në për përmbushjen e këtij angazhimi.

9. Organet e reja të vetëqeverisjes vendore të hartëzojnë shërbimet për fëmijë dhe të rinj, të planifikojnë buxhetimin e shërbimeve të përshtatshme për ta, si dhe të marrin masa për përmbushjen e të drejtave dhe nevojave të fëmijëve në territorin e tyre, veçanërisht atyre me nevoja të veçanta. GDMF-ja do të analizojë përmbushjen e këtij detyrimi nga gjashtëdhjetë e një njësitë e vetëqeverisjes vendore në muajin nëntor 2019.

Miraturar më 28.3.2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

DEKRET Nr. 11149, datë 25.3.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Zamira Sait Dibra (Hoxha)
2. Egreta Jaho Ismajli (Zguri)
3. Rea Besnik Ismajli
4. Riga Besnik Ismajli
5. Kaon Besnik Ismajli
6. Fari Abdi Xhediku
7. Liana Tomson Çeka (Frashëri)
8. Roselda Roald Kurtbegu
9. Ana (Anila) Rado Kerstoviq (Nikaj / Vuçiq / Vučić)
10. Klejva Astrit Warnck (Haxhiu)
11. Ilir Mustafa Koskija
12. Altin Lefter Bila
13. Kliton Shefit Tosku
14. Fatos Allaman Karaj
15. Siderida Shefit Hasa
16. Fatmira Albert Tafa
17. Valmir Merzuk Dibra



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 164, datë 27.3.2019

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
BRENDSHME DHE ZYRA QENDRORE E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME TEK AGJENCIA E
OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), TË
SIPËRFAQEVE 77 m² E 125 m², DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1691,
DATË 10.10.2007, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
BRENDSHME, PËR PREFEKTËT NË
QARQE DHE NËNPREFEKTËT,
ADMINISTRATËN E TYRE, PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
EMERGJENCAVE CIVILE (DREJTORINË
E PMNZSH-së)”, TË NDRYSHUAR, DHE
NR. 448, DATË 16.6.2005, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ZYRËS
QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Brendshme tek Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të një sipërfaqeje prej 77 m², të pronës me numër pasurie 16/51-1, zona kadastrale 8571, lagja “Kongresi”,
Faqe|3694

Lushnjë, për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s, sipas formularit të inventarizimit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tek Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të një sipërfaqeje prej 125 m², të pronës me numër pasurie 16/51 - 2, zona kadastrale 8571, lagja “Kongresi”, Lushnjë, për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s, sipas formularit të inventarizimit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ato dhe/ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore bashkëlidhur vendimit nr. 1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe nënprefektët, administratën e tyre, për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorinë e PMNZSH-së)”, të ndryshuar.

5. Prona e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore bashkëlidhur vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



FORMULARI
PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)										
Bashkia: Lushnjë										
Fusha e përdorimit të pronës: Për ushtrimin e veprimtarisë administrative										
Nr. rend.	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale: sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera Shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	ZK 8571 LU-J - 7	16/51-1	Ndërtesë	Nënprefektura Lushnjë (holli + shkallët), lagjja “Kongresi”, Lushnjë	77	77	Për ushtrimin e veprimtarisë administrative	ADISA	ADISA	Një sipërfaqe prej 77 m ² nga sipërfaqja totale prej 94 m ² e pasurisë me numër 16/51-2 (holli + shkallët) kalon në përgjegjësi administrimi të ADISA-s.
2	ZK 8571 LU-J - 7	16/51-2	Ndërtesë	Z.R.P.P Lushnjë, nënprefektura, lagjja “Kongresi”, Lushnjë	125	125	Për ushtrimin e veprimtarisë administrative	ADISA	ADISA	Një sipërfaqe prej 152 m ² nga sipërfaqja totale prej 250 m ² e pasurisë me numër 16/51-2 kalon në përgjegjësi administrimi të ADISA-s.



**VENDIM****Nr. 165, datë 27.3.2019****PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PARTISË
REPUBLIKANE, SI SELI, TË DISA
MJEDISEVE TË GODINËS
KATËRKATËSHE, ISH-SHTËPIA
BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
“8 NËNTORI”, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Partisë Republikane, si seli, të disa mjediseve të katit të tretë, përkatësisht 6

(gjashtë) zyra në kahun verior të godinës katërkatëshe, të ish-shtëpisë botuese të librit shkollor “8 Nëntori”, sipas kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Partisë Republikane i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 534, datë 4.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen me mjedise të Partisë Republikane”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



Kortela Memo.

Miratur nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 9 , Fq. 9

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijn nga Vol _____, Fq. _____

Zona Kadastrale: 8210 NR.i PASURISE: 5/139

Vijon në: Vol _____, Fq. _____ deri në: Vol _____, Fq. _____ -->

Indeksi i Hartes: **TR; P-8**

PERFUNDIMTARE (data): 20/10/2012

Adresa e Pasurisë: Rrethi **TIRANË** Q/F -

Rr/L _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: **GODINE** Brenda V.K.N. : **PO** , Ref : **PL.RREG**

Përshkrim i vecantë:

GODINE 4 KATE
1881

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtëst	Per pjesen e përbashkët : <u>PALLAT</u> Kuota e pjesmarjes: _____ % Nr i Pasurise (pallat): Vol _____ Faqe _____
1. <u>492.00</u> m ² Ref. <u>00002352</u>	1. <u>492.00</u> m ² Ref. <u>00002352</u>	1. <u>492.00</u> m ² Ref. <u>00002352</u>	
2. <u>558.65</u> m ² Ref. <u>LN0310</u>	2. <u>558.65</u> m ² Ref. <u>LN0310</u>	2. <u>558.66</u> m ² Ref. <u>LN0310</u>	
3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	
4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00002352	21/08/2013	V9 F9 - V9 F 11 F 21-24 V9 F 80,81				I	-				

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)



FORMULAR I AZHORNIMIT FUSHOR TE NJESIVE (TREGËTARE, PRODHUSE, etj.)

00002352

 Zona Kadastrale B210 Nr i Pasurise Pallat 5/139 Ind. Hartes TE-P-8 Vol 9 Faqe 9
 RRETHI TIRANE Q/Ë TIRANE Rr. M. GJOLLEJHA P/G


Nr.	Nr. i njesisë	Emri i pronarit aktual	Emra të pronarëve paraardhës (paraardhësi, paraparaardhësi, ...)	Shtime	
1	N ₁	JH.A. KOMBI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 70 \text{ m}^2$	VP
2	N ₂	SHA MIRA 2H	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 111,0 \text{ m}^2$	VP
3	N ₃	JH.A. GAJUPI	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 78 \text{ m}^2$	VP
4	N ₄	JH.A. KOMBI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 63 \text{ m}^2$	VP
5	N ₅	JH.A. BOT. ENKLOPEDIKE	- JH.TETI	$S = 40 \text{ m}^2$	VP
6	N ₆	JH.A. GAJUPI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 100 \text{ m}^2$	VP
7	N ₇	JH.A. MIRAZH	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 46 \text{ m}^2$	VP
8	N ₈	JH.A. BOTIMET ENKLOPEDIKE	- JH.TETI	$S = 92 \text{ m}^2$	VP
9	N ₉	JH.A. BOT. ENKLOPEDIKE	- JH.TETI	$S = 400,5 \text{ m}^2$	VP
10	N ₁₀				VP

 AZHORNIMI NE TERREN TOPOGRAF ARJANA BLAZHDANI DATE 26.3.2001

**VENDIM****Nr. 166, datë 27.3.2019****PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PARTISË
DEMOKRISTIANE, SI SELI, TË DISA
MJEDISEVE TË GODINËS
KATËRKATËSHE, ISH-SHTËPIA
BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
“8 NËNTORI”, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
FINANCave DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Partisë Demokratike, si seli, të disa mjediseve të katit të katërt,

përkatësisht 6 (gjashtë) zyra në kahun verior, të godinës katërkatëshe, të ish-shtëpisë botuese të librit shkollor “8 Nëntori”, sipas kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Partisë Demokratike i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 533, datë 4.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen me mjedise të Partisë Demokratike”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



FORMULAR I AZHORNIMIT FUSHOR TE NJESIVE (TREGËTARE, PRODHUSE, etj.)

00002352

 Zona Kadastrale B210 Nr i Pasurise Pallat 5/139 Ind. Hartes TE-P-8 Vol 9 Faqe 9
 RRETHI TIRANE Q/Ë TIRANE Rr. M. GJOLLEJHA P/G


Nr.	Nr. i njesisë	Emri i pronarit aktual	Emra të pronarëve paraardhës (paraardhësi, paraparaardhësi, ...)	Shënime	
1	N ₁	JH.A. KOMBI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 70 m^2$	VP
2	N ₂	SHA MIRA 2H	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 111,0 m^2$	VP
3	N ₃	JH.A. GAJUPI	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 78 m^2$	VP
4	N ₄	JH.A. KOMBI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 63 m^2$	VP
5	N ₅	JH.A. BOT. ENKLOPEDIKE	- JH.TETI	$S = 40 m^2$	VP
6	N ₆	JH.A. GAJUPI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 100 m^2$	VP
7	N ₇	JH.A. MIRAZH	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 46 m^2$	VP
8	N ₈	JH.A. BOTIMET ENKLOPEDIKE	- JH.TETI	$S = 92 m^2$	VP
9	N ₉	JH.A. BOT. ENKLOPEDIKE	- JH.TETI	$S = 400,5 m^2$	VP
10	N ₁₀				VP

 AZHORNIMI NE TERREN TOPOGRAF ARJANA BLAZHDANI DATE 26.3.2001

**VENDIM****Nr. 169, datë 27.3.2019****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 16, DATË 16.1.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2019, NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 16, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 1 748 (një mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) punonjës.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1 dhe bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në krye të tabelës shtohet ndarja “Gr. 1, institucioni i Presidentit të Republikës”, me përmbajtje sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Në ndarjet “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”; “Gr. 13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”; “Gr. 15, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme”; “Gr. 16, Ministria e Brendshme”, dhe “Gr. 26, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”, shtohen nëndarjet përkatëse sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në tabelën bashkëlidhur të këtij vendimi të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Gr.	Emri i Institucionit		Emërtesa	ditore	Periudhë kohore
1	Institucioni i Presidentit të Republikës	3			
	Institucioni i Presidentit të Republikës	2	Sanitar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Institucioni i Presidentit të Republikës	1	Teknik i mesëm	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	20			
	AZHBR	1	Sanitar	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	AZHBR	3	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	AZHBR	14	Specialist	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	AZHBR	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	AZHBR	1	Punonjës arkive	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	17			
	Qendra Polivalente e Përkujdesit Social Polican	1	Mjek i Përgjithshëm	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Foshnjës Tiranë	1	Mjek i Përgjithshëm	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	1	Mjek i Përgjithshëm	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Mjek i Përgjithshëm	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e të Moshuarve Fier	1	Sanitar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	1	Mjek i Përgjithshëm	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	1	Sanitar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Foshnjës Durrës	1	Mjek Pediatër	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Foshnjës Korçë	1	Mjek Pediatër	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Foshnjës Shkodër	1	Mjek Pediatër	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Foshnjës Vlorë	1	Mjek Pediatër	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Shkodër	1	Mjek Pediatër	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Sarandë	1	Mjek Pediatër	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Qendra e Zhvillimit Korçë	1	Mjek i Specializuar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Qendra e Zhvillimit Vlorë	1	Mjek i Specializuar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Qendra e Zhvillimit Berat	1	Mjek i Specializuar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Qendra e Zhvillimit Shkodër	1	Mjek i Specializuar	4 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
15	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	6			
	Aparati i Ministrisë për task forcën dhe njësinë	1	Teknik i mesëm	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë për task forcën dhe njësinë	4	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë për task forcën dhe njësinë	1	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 Muaj
16	Ministria e Brendshme	6			
	Policia e Shtetit (per procesin zgjedhor)	3	Teknikë të mesëm	8 orë/ditë	3 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Komisionet e vetingut)	1	Sanitar	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Aparati i Ministrisë (Komisionet e vetingut)	1	Punonjës protokoll/arkive	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore	1	Sanitar	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	3			
	Aparati	2	Punonjës arkiv- protokolli	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	Aparati	1	Specialist	6 orë/ditë	Prill 2019- Dhjetor 2019
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	55			



VENDIM
Nr. 170, datë 27.3.2019

**PËR SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN
E FONDIT 1 000 000 000 (NJË MILIARD)
LEKË NË PROGRAMIN “MENAXHIMI I
INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE
KULLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe

kullimit”, për projektet e ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave, sipas bashkive dhe drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për projektet sipas tabelës 2 të këtij vendimi, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural caktohet në rolin e organit qendror blerës për kryerjen e procedurës së prokurimit.

3. Projektet për rehabilitimin e digave, para fillimit të procedurës së prokurimit, të jenë të miratuara në Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1. Lista e projekteve

Nr.	Institucioni përfitues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2019	Financimi për vitin 2020
		Totali	1,806,389,097	1,000,000,000	806,389,097
		<i>Projekte për rehabilitimin e digave</i>	448,112,980	189,438,520	258,674,460
1	Bashkia Krujë	Rehabilitimi digës së ujëmbledhësit Tapizë	208,640,000	80,000,000	128,640,000
2	Bashkia Mat	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shoshaj	22,953,070	14,700,000	8,253,070
3	Bashkia Roskovec	Rehabilitim i ujëmbledhësit Kurjan	27,684,250	14,738,520	12,945,730
4	Bashkia Kamzë	Rezervuari Paskuqan	64,835,713	25,000,000	39,835,713
5	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i digës së rezervuarit Kukaj	28,000,000	10,000,000	18,000,000
6	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Arapaj 1	29,945,787	15,000,000	14,945,787
7	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Spitallë	20,054,160	10,000,000	10,054,160
8	Bashkia Rrogozhinë	Rehabilitimi i digës dhe skemës ujitëse të rezervuarit të Okshtunit	46,000,000	20,000,000	26,000,000
		<i>Projekte për infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja</i>	1,358,276,117	810,561,480	547,714,637
2	Bashkia Elbasan	Përroi i Zaranikës	200,000,000	70,000,000	130,000,000
3	Bashkia Fier	Dega ujitëse e Fierit	42,300,000	20,000,000	22,300,000
4	Bashkia Divjakë	Skema ujitëse - Sektori i Ri në Xeng	70,536,158	28,573,126	41,963,032
5	Bashkia Kolonjë	Kanali ujitës Kabash, Leskovik	17,000,000	10,000,000	7,000,000
6	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i pjesshëm i Degës Ventrok	40,960,000	15,000,000	25,960,000
7	Bashkia Pustec	Pastrimi i kanaleve II dhe III kullues dhe ndërtim urash	1,026,479	1,026,479	
8	Bashkia Mirditë	Rehabilitim i skemës ujitëse ujëmbledhësi Malaj-2 (faza 3)	51,039,370	20,000,000	31,039,370



9	Bashkia Malësi e Madhe	Skemë ujëtse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, loti 2	48,126,458	35,000,000	13,126,458
10	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i Kanalit Vaditës fshati Qerret	25,500,000	15,000,000	10,500,000
11	Bashkia Shkodër	Kanali ujëtës KU-21	14,510,321	14,510,321	
12	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i Kanalit Ujëtës Hardhishtë-Rreth	64,324,175	25,000,000	39,324,175
13	Bashkia Belsh	Kanali i Ujëtës Çerragë	57,404,221	25,000,000	32,404,221
14	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i kanalit ujëtës Galigat-Cingar Sipër-Drizë	33,652,246	20,000,000	13,652,246
15	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion i kanalit vaditës Gurakuq Kuturman (loti I, ndërtimi i sifonit të madh)	32,454,000	15,000,000	17,454,000
16	Bashkia Këlcyrë	Skema ujëtse Ballaban, ujëtja e Fushës Ballaban, vazhdim	27,970,217	10,000,000	17,970,217
17	Bashkia Tepelenë	Rehabilitimi i kanaleve ujëtës të Dukaj (1.4 km) dhe digës së ujëmbledhësit Dukaj, Bashkia Tepelenë	13,194,000	13,194,000	
18	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksion i Kanalit Ujëtës Vija e Mullirit Gjoricë	42,800,328	20,000,000	22,800,328
19	Bashkia Dibër	Kanali ujëtës Përroi i Llixhave, lagjja “Dobrovë”	7,660,000	7,660,000	
20	Bashkia Dibër	Sifoni ujëtës dalja e rezervuarit Shumbat	10,183,000	10,183,000	
21	Bashkia Kukës	Rehabilitim i kanalit ujëtës Bushat, Njësia Administrative Bicaj Bashkia Kukës	17,115,990	10,000,000	7,115,990
22	Bashkia Roskovec	Rehabilitimi i pesë kanaleve ujëtse në zonën e Sukut	55,607,977	20,000,000	35,607,977
23	Bashkia Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujëtës U.3-15, U.3-15/4, U.3-15/5 në fshatin Fier i Ri, Nj. Ad. Krutje	18,566,441	10,000,000	8,566,441
24	Bashkia Vlorë	Kanali ujëtës VLU-10	13,750,000	11,115,990	2,634,010
25	Bashkia Ura Vajgurore	Kanali ujëtës BRU-15 Manastir dhe ushqyesi i rezervuarit	24,379,994	15,000,000	9,379,994
26	Bashkia Cërrik	Rehabilitim sistemi ujëtës	28,000,000	15,000,000	13,000,000
27	Bashkia Fushë Arrëz	Rikonstruksion i kanalit fshati Iballë	30,816,178	15,000,000	15,816,178
28	Bashkia Përmet	Kanali Strembec	22,700,000	12,700,000	10,000,000
29	Bashkia Libohovë	Rehabilitimi i skemës ujëtse të Bulos, si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë-Nepravishhtë	37,100,000	17,000,000	20,100,000
30	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Fier	Mbrojtja nga Gërryerja lumi Kseras, krahu i majtë (zonat I, II dhe III), Gjrokaštër	79,598,564	79,598,564	
31	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Fier	Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Kashisht	82,000,000	82,000,000	
32	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Durrës	Argjinatura mbrojtëse Zalli Sines	45,000,000	45,000,000	
33	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Korçë	Mbrojtje nga përmbytjet nga lumi Shkumbin në Shushicë (lagjja “Gogollaret”)	38,000,000	38,000,000	
34	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Lezhë	Argjinatura e lumit Drin, krahu i djathtë i rrjedhës Ishull Shëngjin	65,000,000	65,000,000	

Tabela 2. Lista e projekteve

Nr.	Institucioni përfitues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2019	Financimi për vitin 2020
		Totali	509,598,564	379,598,564	130,000,000
1	Bashkia Elbasan	Përroi Zaranikës	200,000,000	70,000,000	130,000,000
2	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Fier	Mbrojtja nga gërryerja lumi Kseras, krahu i majtë (zonat I, II dhe III), Gjrokaštër	79,598,564	79,598,564	
3	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Fier	Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Kashisht	82,000,000	82,000,000	
4	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Durrës	Argjinatura mbrojtëse Zalli Sines	45,000,000	45,000,000	
5	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Korçë	Mbrojtje nga përmbytjet nga lumi Shkumbin në Shushicë (lagjja “Gogollaret”)	38,000,000	38,000,000	
6	Drejtoria e Ujëtës dhe Kullimit Lezhë	Argjinatura e lumit Drin, krahu i djathtë i rrjedhës Ishull Shëngjin	65,000,000	65,000,000	



VENDIM
Nr. 171, datë 27.3.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KUSHTET DHE KRITERET E
USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË
STACIONIT TË PLAZHIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, sipas tekstit dhe shtojcave 1, 2, 3, 4 e 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 369, datë 18.5.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, dhe dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e stacionit të plazhit në vendimin nr. 321, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, të ndryshuar, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, inspektorati përgjegjës për turizmin, inspektorati përgjegjës për mjedisin, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE KRITERET E
USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË
STACIONIT TË PLAZHIT

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjitha zonat bregdetare, si dhe në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë identifikuar si zona të përshtatshme për plazhe, me qëllim ofrimin

e kushteve të përshtatshme e të standardeve cilësore për pushuesit.

Neni 2
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

2. Përveç tyre, në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Plazh”**, zona me rërë, zhavorr apo shkëmb, që shtrihet në buzë të ujit të detit, lumit apo liqenit, e cila është pronë ekskluzive e shtetit dhe administrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e hapur për përdorim të lirë publik dhe që është identifikuar si e përshtatshme për zonë çlodhjeje, argëtuese e që konsiderohet e parrezikshme nga pikëpamja shëndetësore apo e sigurisë për përdorim nga pushuesit;

b) **“Plazh i lejuar”**, ato plazhe që janë identifikuar sipas shtojcës 1, të kësaj rregulloreje, ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit sipas kushteve dhe kriterëve të kësaj rregulloreje;

c) **“Rregullore e detajuar e stacioneve të plazhit”**, tërësia e rregullave të detajuara që përfshin procedurat për përzgjedhjen e subjektit dhe rregullat për vendosjen e pajisjeve, objekteve dhe lehtësirave të tjera në funksion të tipologjisë së plazhit, e cila i bashkëngjitet kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit. Modeli i rregulloreve të detajuara të stacioneve të plazhit miratohet me vendim të këshillit bashkiak;

ç) **“Plazh publik”**, zona të plazheve të lejuara dhe të administruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të hapura për përdorim publik e që ofrojnë kërkesa minimale për sigurinë dhe higjienën;

d) **“Vrojtues plazhi”**, personi i kualifikuar dhe i certifikuar nga Qendra e Formimit Profesional për vrojtues plazhi, për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore;

dh) **“Zonë shërbimesh”**, zona ku ndodhen shërbimet higjieno-sanitare, kabinat e veshjes dhe baret.

Neni 3
Tipologjia e plazheve

1. Plazhet në bazë të vijës së bregut të detit ose të liqenit dhe të karakteristikave të tjera natyrore ndahen në plazhe të tipit A, B, AB e C:



a) Plazh i tipit A është plazhi kryesisht me përbërje ranore dhe gjerësi të konsiderueshme të brezit të plazhit, e cila nuk është më e vogël se 60 (gjashtëdhjetë) m vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose të liqenit;

b) Plazh i tipit B është plazhi kryesisht me përbërje shkëmbore dhe zhavorri dhe me gjerësi të brezit të plazhit, e cila nuk është më e madhe se 60 (gjashtëdhjetë) m vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose liqenit;

c) Plazh i tipit AB është plazhi i ndërthurur, i cili përmban karakteristika si të tipave A e B;

ç) Plazh i tipit C është plazhi i virgjër, për përdorim të lirë, në të cilin nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi, përveç mirëmbajtjes dhe pastrimit të mbeturinave nga njësia e vetëqeverisjes vendore që e ka në administrim.

2. Hapësirat e plazheve të lejuara, të cilat nuk janë dhënë në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, janë në përdorim të lirë të pushuesve dhe mirëmbahen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe ministrinë përgjegjëse për turizmin, përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara. Kjo hartë përmban, si më poshtë vijon:

a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi;

b) hapësirat e plazhit publik;

c) vendndodhjen e kullave dhe pikave të vrojtimit;

ç) zonën e çadrave;

d) zonën e shërbimeve;

dh) hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrethuar me bova);

e) vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre;

ë) zonat rekreative etj.

2. Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik do të bëhet proporcionalisht, sipas raportit 80%/20% dhe në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare. Hapësira e çdo plazhi (publik ose privat) kufizohet me vijën bregdetare.

3. Harta e përgjithshme hartohet nga një grup pune i drejtuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në përbërje të së cilës ka përfaqësues nga

ministria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe miratohet, brenda muajit janar, me vendim të këshillit bashkiak.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në datën 31 mars, të çdo viti, duhet të kenë lidhur të gjitha kontratat e qirasë për përdorimin e plazheve. Plazhet për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në këtë datë, do të funksionojnë si plazhe publike.

Neni 5

Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit

1. Veprimtaria e stacionit të plazhit ushtrohet nga çdo person fizik/tregtar apo juridik i përzgjedhur nga njësia e vetëqeverisjes vendore sipas kriterëve të parashikuara në këtë rregullore, i cili lidh një kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit të vënë në dispozicion. Në rastin e kërkesave të projekteve me potencial strategjik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, apo kërkesave të investitorëve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit lidhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore shqyrton kërkesat e ardhura nga subjektet private të interesuara për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke marrë parasysh kriteret, si më poshtë vijon:

a) subjekti ka eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe/ose veprimtarive të tjera turistike në plazh, për të cilat nuk është dhënë ndonjë masë administrative nga institucionet përkatëse;

b) plani i biznesit i subjektit përmbush standardet minimale për ruajtjen e bregdetit dhe natyrës, pastrimin e hapësirës së plazhit dhe sigurisë së pushuesve në aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe është i realizueshëm bazuar në buxhetin e parashikuar në planin e biznesit.

3. Në aplikimin për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit subjektet e interesuara paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën e subjektit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;

b) planin e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë



së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve;

c) dokumentacionin për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit. Në këtë rast, njësia e vetëqeverisjes vendore, para lidhjes së kontratës, ka detyrimin që të verifikojë nëse subjekti aplikues ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontratat e mëparshme;

ç) ekstraktin e regjistrimit të subjektit të lëshuar nga organet përkatëse, nëse ka;

d) vërtetimin nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;

dh) vërtetimin nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore lidhur me aktivitetin;

e) vetëdeklarimin se subjekti është njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mban përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, sipas formatit të shtojcës 5 bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ministria përgjegjëse për turizmin duhet të njoftojë bashkitë respektive për kërkesat për investime strategjike në plazhe brenda muajit të çdo viti. Ndërkohë që njësia e vetëqeverisjes vendore, përpara dhënies në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duhet të marrë paraprakisht konfirmimin nga ministria përgjegjëse për turizmin nëse hapësira e plazhit të kërkuar është objekt i ndonjë kërkesë sipas ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ose është objekt i ndonjë kërkesë për investitorët në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit. Në këtë rast kërkesa e subjektit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, dorëzuar pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, refuzohet.

5. Pas verifikimeve të lartpërmendura, njësia e vetëqeverisjes vendore shqyrton kërkesat e ardhura nga subjektet private dhe pranon ose refuzon këto kërkesa brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore, në dhënien në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, i jep përparësi sipas radhës:

a) subjekteve që ushtrojnë një aktivitet të lidhur me shfrytëzimin e plazhit (strukturë akomoduese apo bar-restorant pranë hapësirës së plazhit që kërkohet ose veprimtari tjetër turistike në plazh);

b) subjekteve fizike dhe juridike të tjera.

7. Përveçse kur zbatohen kriteret e tjera, të përcaktuara në legjislacionin për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për projekte investuese në zonat me përparësi turizmin, hapësirat e plazhit të dhënë në përdorim për stacione plazhi, nuk mund të jenë më të vogla se 200 (dyqind) m² dhe më të mëdha se 5 000 (pesë mijë) m².

8. Subjektet e interesuara, pasi përzgjidhen:

a) regjistrohen si subjekte tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, nëse nuk janë të regjistruara që në fazën e aplikimit;

b) paraqesin një marrëveshje paraprake me vrojtues plazhi, e cila të garantojë sigurinë në stacionin e plazhit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Pas plotësimit të këtyre kushteve, subjektet nënshkruajnë me njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse kontratën e qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të plazhit, sipas modelit të kontratës të parashikuar në shtojcën 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

9. Kontrata për dhënien në përdorim të hapësirave të plazhit mund të nënshkruhet me afat nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet, me të drejtë rinovimi.

10. Njësitë e vetëqeverisjes vendore detyrohet të përcjellin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e fundit e afatit të dhënë për nënshkrimin e kontratës, listën me të dhënat e subjekteve, duke përfshirë edhe sipërfaqet e dhëna me qira pranë prefektit të qarkut, ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe inspektoratit përgjegjës për turizmin.

11. Stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data 1 maj deri më 30 shtator të çdo viti dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrojë të gjitha shërbimet e të përmbushë të gjitha kushtet minimale të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti.



Neni 6

Kushtet minimale të stacionit të plazhit sipas tipologjisë së plazhit

1. Kushtet minimale që duhet të përmbushë një stacion plazhi në plazhet e tipit A, janë, si më poshtë vijon:

a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 7.5 (shtatë pikë pesë) m nga vija e bregut të detit, liqenit, lumit;

b) hapësira prej 2.5 (dy pikë pesë) m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;

c) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 (dy pikë pesë) m në linjë vertikale me vijën e ujit;

ç) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël për çdo 100 (njëqind) çadra;

d) të jetë i pajisur me shërbime higjienike, të paktën 2 (dy) për çdo kapacitet deri në 100 (njëqind) çadra, nga të cilat 1 (një) e ndarë në njësi për femra dhe meshkuj dhe 1 (një) për njerëzit me aftësi të kufizuara; njësia për njerëzit me aftësi të kufizuara mund të përfshihet në secilën njësi për femra dhe meshkuj, duke zmadhuar sipërfaqen e këtyre njësive të shërbimit në dimensionet maksimale 1,80 m x 1,80 m;

dh) të ketë të paktën 2 (dy) kabina zhveshjeje për çdo kapacitet deri në 50 (pesëdhjetë) çadra; sipërfaqja totale e kabinave të zhveshjes nuk duhet të jetë më e vogël se 1 (një) % e sipërfaqes së hapësirës së plazhit të dhënë në përdorim;

e) të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve, si dhe me pajisjet përkatëse për dhënien e ndihmës së shpejtë për pushuesit; ky ambient duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i identifikueshëm dhe të lihen korridore të lira kalimi për transportin në raste emergjence;

ë) prania e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të Ambulancës, Policisë, Zjarrfikëses, Kapitanerisë së Portit, QNOD-it;

f) të jetë i pajisur me telefon publik në dispozicion të pushuesve;

g) të jetë i pajisur me kontejnerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave;

gj) çdo çadër duhet të jetë e pajisur me 2 (dy) krevate plazhi;

h) të reklamojë identitetin e subjektit që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit dhe çmimet për shërbimin e ofruar;

i) stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniforme dalluese;

j) të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit;

k) shërbimi për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit të jetë ditor, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit; gjithashtu, gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave;

l) në të gjithë territorin e plazhit ndalohet vendosja e elementeve ndarëse, gardhe apo të tjera të ngjashme me to.

2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë një stacion plazhi në plazhet e tipit B, janë, si më poshtë vijon:

a) çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të vendosen pranë bregut të detit, duke lënë hapësirë të mjaftueshme për lëvizjen e lirë të pushuesve;

b) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë të paktën 2.5 (dy pikë pesë) m;

c) të gjitha kushtet e përcaktuara për tipin A, në pikën 1, përveç shkronjave “b”, “c” dhe “ç”.

3. Kushtet minimale që duhet të plotësojë një stacion plazhi në plazhet e tipit AB, janë, si më poshtë vijon:

a) për hapësirat, të cilat përmbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit A, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit A, sipas pikës 1, të këtij neni;

b) për hapësirat, të cilat përmbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit B, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit B, sipas pikës 2, të këtij neni.

4. Nuk mund të ndalohet apo të kufizohet, në asnjë formë dhe në asnjë kohë, kalimi i publikut në rrugët që lidhin rrugën publike me plazhin publik. Subjektet e veprimtarisë së stacionit të plazhit kanë detyrimin për të krijuar kushtet e kalimit lirisht të publikut dhe moscenimin në ndonjë formë të kësaj të drejte, si dhe sigurimin e kushteve të kalimit lirisht të personave me aftësi të kufizuara.

5. Në rastin e bllokimit të rrugëve ekzistuese nga subjektet ushtruese të veprimtarisë së stacionit të plazhit, njësia e vetëqeverisjes vendore me të cilin



është lidhur kontrata nga subjekti që ushtron këtë veprimtari merr masa të menjëhershme për lirimin e këtyre rrugëve vullnetarisht nga këto subjekte ose të ndërtimit të rrugëve të reja, me parametrat e duhur për të mundësuar aksesin e publikut në plazh.

6. Në stacionet e plazhit, në hapësirën midis bregut dhe zonës së çadrave, nuk lejohen shitësit ambulantë.

7. Krite me të detajuara mund të parashikohen në çdo rregullore të stacionit të plazhit, bashkëlidhur kontratës së dhënies në përdorim.

Neni 7

Kërkesat për sigurinë në stacionet e plazhit

1. Të gjitha stacionet e plazhit kanë detyrimin e vendosjes, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së kushteve higjienike dhe të sigurisë për jetën, të caktuara në këtë rregullore, si dhe kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e detit dhe bregut të detit për zonën para stacionit të plazhit, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimet me shpenzimet e tyre.

2. Kërkesat për sigurinë të përcaktuara në këtë nen zbatohen për sa është e mundur edhe për plazhet publike.

3. Të gjitha stacionet e plazhit kanë për detyrë të respektojnë kriteret dhe kushtet për sigurinë e shëndetit dhe jetës të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me aktivitetet e ndryshme specifike që zhvillohen e ofrohen në stacionet e plazhit.

4. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të garantojnë shërbimin me vrojtues plazhi përgjatë gjithë kohës që subjekti ushtron aktivitetin e tij, për çdo 80 (tetëdhjetë) m vijë lineare bregdetare. Për stacionet e plazhit, me vijë lineare bregdetare mbi 80 (tetëdhjetë) m, pajisjen me pika vrojtimi për çdo fraksion 80 (tetëdhjetë) m linear. Edhe stacionet e plazhit me vijë lineare bregdetare nën 80 (tetëdhjetë) m kanë detyrimin të kenë vrojtues plazhi.

5. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të kenë:

a) Sinjalizimin dhe kufizimin me bova (me diametër 22 cm) me ngjyrë të kuqe, të lidhura me litar pluskues me njëra tjetrën, çdo 30–50 m të hapësirës ujore përpara stacionit të plazhit të dedikuar për not, e cila duhet të jetë deri në:

i. 200 (dyqind) m nga bregu për plazhet e tipit A;

ii. 100 (njëqind) m nga bregu për plazhet e tipit B

Deri në thellësinë 1.6 m (një pikë gjashtë) të vendosen bova (me diametër 22 cm), me ngjyrë të bardhë, e cila sinjalizon pushuesit për zonën e sigurt për notim. Bovat duhet të jenë të mirankoruara dhe të kontrollohen periodikisht nëse ato kanë lëvizur nga pozicioni i tyre nga dallgët, era apo shkaqe të tjera.

b) sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim, zonat për përdorimin dhe ankorimin e mjeteve lundruese me ose pa motor, jashtë zonave të përcaktuara për not sipas shkronjës “a”, më sipër, duhet të jenë të kufizuara, duke ofruar vende për ankorim (kalata), vendparkim në tokë dhe bova për përcaktimin e korridoreve për afrimin dhe parkimin në tokë të mjeteve ujore me ose pa motor. Në zonat e përdorimit dhe ankorimit të mjeteve lundruese për argëtim, aktivitetet e notimit janë të ndaluara. Sinjalizimin me tabela informuese në shqip dhe në anglisht, në vend të dukshëm pranë bregut të detit “Zonë e ndaluar për notim” dhe “No swimming area”;

c) vendosjen e flamujve me shkop, çdo ditë, gjatë sezonit të verës; subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit duhet të vendosë një flamur në përputhje me kushtet e motit dhe të detit, i cili mund të ndryshohet gjatë ditës, nëse ndryshojnë kushtet e motit apo të detit, si më poshtë vijon:

i. flamur i gjelbër – lejohet notimi;

ii. flamur i verdhë – notim me masa mbrojtëse;

iii. flamur i kuq – ndalohet notimi.

Në shkopin e flamurit duhet të ketë edhe një tabelë sqaruese në shqip dhe anglisht për sinjalistikën me flamur dhe me informacion mbi kushtet e plazhit. Shkopi i flamurit duhet të jetë 3.5 m i lartë, i dukshëm në të gjithë zonën;

ç) Pajisjen e çdo stacioni të plazhit me pikë vrojtimi, pajisjet e të cilave janë përcaktuara në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi. Pika e vrojtimit duhet:

i. të jetë e vendosur në pozicion qendror referuar strukturës së stacionit të plazhit ose vijës bregdetare në përdorim;

ii. të jetë e avancuar në krahasim me vijën e parë të çadrave;

iii. të ketë një fushë pamjeje dhe veprimi të lirë;



iv. të jetë mbulesa e çadrës ose tendës së pikës së vrojtimit me pëlhurë të kuqe, lehtësisht e identifikueshme, ku të shkruhet qartë “VROJTUES PLAZHI”/ “*LIFEGUARD*”;

d) Pajisjen e plazheve publike me kulla vrojtimi, pajisjet e të cilave përcaktohen në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi. Distanca për pajisjen me kullë vrojtimi në këto plazhe, për aq sa është e mundur, do të jenë sa distancat e parashikuara për pikat e vrojtimit në stacionet e plazhit dhe duhet të ketë lartësi 3 m dhe fushë pamjeje e veprimi të lirë;

dh) Çdo “stacion plazhi” dhe “plazh publik” duhet të garantojë shërbimin me vrojtues plazhi. Vrojtuesi i plazhit punësohet nga subjekti publik dhe privat që ka në përdorim/administrim hapësirën e plazhit dhe duhet të garantojë përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së plazhit. Mungesa e shërbimit me vrojtues plazhi, konstatuar nga inspektorati përgjegjës i turizmit, do të përbëjë shkak për zgjidhjen e kontratës me objekt ushtrimin e veprimtarisë “Stacion plazhi”.

6. Për plazhet publike, të cilat administrohen nga njësitë vendore, në të cilat nuk mund të ofrohen kriteret e sigurisë, duhet të vendosen tabela informuese lehtësisht të dallueshme, me mbishkrime (në shqip e në anglisht) “KUJDES! – KY PLAZH NUK KA VROJTUES PLAZHI.” / “*ATTENTION! - THIS BEACH HAS NO LIFEGUARD.*”.

7. Çdo stacion plazhi dhe kullë vrojtimi duhet të ketë të afishuar:

7.1. kanalet për komunikim emergjence, si:

- a) shërbimi i urgjencës mjekësore;
- b) Policia e Shtetit dhe Policia Kufitare;
- c) zjarrfikëset;
- ç) Kapitaneria Detare;
- dh) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

7.2 Në mënyrë të dukshme, këshillat drejtuar pushuesve, si më poshtë vijon:

- a) Noto vetëm në zonat e autorizuar dhe me sinjalistikë.
- b) Respekto flamurin dhe informacionin e afishuar.
- c) Ndalohet notimi nën ndikimin e alkoolit apo drogave.
- ç) Mos noto, nëse ke ndonjë problem fizik.
- d) Pusho për një orë pas ngrënies, para se të shkosh për notim.

dh) Të miturit nën 16 vjeç duhet të jenë gjithmonë nën mbikëqyrjen e më të rriturve.

e) Mos u hidh nga shkëmbinj apo platforma përveç vendeve të autorizuar me sinjalistikë.

ë) Ndiq udhëzimet e vrojtuesit (rojës së shpëtimit të jetës).

f) Mbaj pastër mjedisin.

g) Në rast EMERGJENCE në det, telefono 112.

8. Lejohet aktiviteti i dhënies me qira të pedaloneve apo i mjeteve të tjera ujore dhe përdorimi i tyre duhet të bëhet jashtë zonës së notimit. Lëvizja e motorëve të ujit apo varkave motorike duhet të bëhet në një distancë prej 300 m nga zona e notimit.

9. Ofrimi i shërbimeve dhe plotësimi i kushteve të përmendura më sipër bëhet me shpenzimet e mbajtësit të autorizimit të stacionit të plazhit.

10. Kontrata e përdorimit të hapësirës së plazhit mund të parashikojë kriteret më të detajuara të stacionit të plazhit sipas tipologjisë së plazhit.

Neni 8

Detyrat e vrojtuesit të plazhit

Vrojtuesi i plazhit ka si detyrim:

a) të ketë njohuri për kuadrin ligjor të funksionimit të stacionit të plazhit, teknikat e shpëtimit dhe dyluftimit në ujë, dhënien e ndihmës së parë mjekësore, për hidrometeorologjinë, karakteristikat e brigjeve shqiptare dhe rrymat ujore në to, si dhe mbi sigurinë e mjedisit ujor me referim të veçantë për të njohur faktorët e rrezikshëm që mund të jenë të pranishëm në ujë;

b) të jetë i angazhuar ekskluzivisht në shërbim të vrojtimit-shpëtimit dhe të jetë i pranishëm përgjatë gjithë kohës pranë pikës së vrojtimit, përjashtuar rastet emergjente;

c) të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyrë të kuqe gjatë shërbimit. Uniforma ka të shkruar në pjesën e përparme logon, në krahun e majtë, simbolin e flamurit shqiptar, në krahun e djathtë numrin e matrikullës dhe, në pjesën e pasme, në mënyrë të dukshme qartë, “Vrojtues plazhi” dhe “*Lifeguard*”;

ç) të sinjalizojë pranë organeve kompetente në rastet kur verifikohen kundërvajtje në territorin e stacionit të plazhit dhe në hapësirën ujore përballë tij;



d) të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit dhe të bëjë zëvendësimin e materialeve të konsumuara në kutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të mbajë në efikasitet mjetet e shpëtimit;

dh) të ketë certifikatën dhe kartën ekuivalente të certifikatës brenda afatit të vlefshmërisë, lëshuar nga qendra e formimit profesional përkatës. Rinovimi i saj bëhet sipas rregullores së subjektit certifikues, me qëllim monitorimin e aftësive fizike, mendore të vërtetuesit.

Neni 9

Kritere të përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit

1. Strukturat dhe pajisjet e përdorura në stacionin e plazhit, përveç instalimeve sanitare publike dhe pikat e vërtetimit/kullave të vërtetimit, duhet të çmontohen me përfundimin e afatit të parashikuar në kontratë për sezonin e plazhit të vitit respektiv, për t'i kthyer plazhit karakterin e tij natyror.

2. Strukturat e përdorura duhet të jenë:

a) struktura lehtësisht të çmontueshme, të realizuara me elemente, të tilla si: druri, panele të parafabrikuara të lehta, mbulesa të lehta, PVC, që nuk e dëmtojnë mjedisin në momentin e zhvendosjes;

b) pajisje të lëvizshme, të instalueshme vetëm për periudhën e sezonit të plazhit dhe të cilat mund të hiqen me mbylljen e tij, p.sh.: çadra, krevate plazhi, tavolina, akseset për të shkuar në det, struktura të vogla prej druri etj.

c) struktura të sigurt, të kenë sistemet e montimit me bulona, strukturat e shërbimeve mund të jenë të përkohshme.

3. Në stacionet e plazheve mund të ketë 3 tipologji çadrash:

a) me kashtë;

b) me pëlhurë (tekstil);

c) tendë kashte apo pëlhure.

4. Brenda brezit të shërbimeve mund të realizohen këto struktura: kioskë menaxhimi për plazhin, kabina, shërbime higjienike, depo, pika vërtetimi/kulla e vërtetimit, hapësirë për rojën e plazhit (në rastin e plazhit publik), *beach-bar*, hapësirë për fëmijët, hapësira relaksimi me tavolina, hapësirë për vendosjen e biçikletave. Materialet që lejohen të përdoren për këto struktura janë: dru, kashtë, kallama, tenda të lehta, struktura të

çmontueshme, në mënyrë që të magazinohen gjatë sezonit të dimrit dhe të transportohen përgjatë zonës bregdetare, në rast nevojë.

Neni 10

Respektimi i kushtit për nivelin e lejuar të zhurmave

Çdo stacion plazhi është i detyruar të respektojë nivelin kufi të zhurmave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për zhurmat, si dhe/ose në planet vendore të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Neni 11

Verifikimi i kushteve dhe kritereve

1. Inspektorati përgjegjës për turizmin, në bashkëpunim me inspektoratet përgjegjëse, verifikon respektimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore nga subjektet që kanë lidhur një kontratë qiraje me organet e vetëqeverisjes vendore.

2. Inspektorati përgjegjës për turizmin, në përfundim të inspektimit të kryer, njofton për çdo shkelje të konstatuar të rëndë dhe/ose të përsëritur, njësinë e vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave të nevojshme, deri në zgjidhjen e menjëhershme të kontratës.

Neni 12

Rinovimi i kontratës

1. Në rastin e kërkesës për rinovimin e kontratës së përdorimit të hapësirës së plazhit nga një subjekt, i cili ushtron aktivitetin e stacionit të plazhit, subjekti duhet t'i paraqesë njësisë së vetëqeverisjes vendore kërkesën për rinovim me shkrim të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të kontratës së qirasë të lidhur me të.

2. Për rinovimin e kontratës, së bashku me kërkesën, subjekti duhet:

a) të ketë përmbushur të gjitha detyrimet sipas kontratës së qirasë të lidhur me njësinë e vetëqeverisjes vendore;

b) të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore, vërtetuar nga autoritetet tatimore.

3. Përveç sa më sipër, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të kërkojnë edhe dokumentacion shtesë sipas specifikave të stacionit të plazhit.

4. Njësia e vetëqeverisjes vendore miraton ose refuzon kërkesën e subjektit për rinovimin e



kontratës brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e kërkesës së shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

5. Në rast të shkeljeve të rënda ose të përsëritura, të gjetura nga inspektorati përgjegjës për turizmin, për të cilat është njoftuar njësi e vetëqeverisjes vendore, kjo e fundit nuk mund të rinovojë kontratën e qirasë për përdorimin e plazhit.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

1. Përfundimisht, për vitin 2019, nuk zbatohet:
 - a) parashikimi i pikës 3, të nenit 4, të kësaj rregulloreje;
 - b) rregullorja e detajuar e stacioneve të plazhit e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 2, të kësaj rregulloreje.
2. Përfundimisht, për vitin 2019, afati kohor i lidhjes së kontratës, sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, do të jetë data 20 prill 2019.

SHTOJCA 1 LISTA E PLAZHEVE

Nr. rendor	Nr. kord.	Plazhet	x	y
1	1	Plazhi i Velipojës	367882.7	4635417.4
2	2	Plazhi i Velipojës	370879.3	4635231.1
3	1	Plazhi i Shëngjinit	383017.1	4629870.0
4	2	Plazhi i Shëngjinit	383803.2	4628015.1
5	1	Plazhi i Tales	382002.5	4619791.4
6	2	Plazhi i Tales	381645.7	4615499.0
7	1	Plazhi i Gjirit të Lalzit	375335.5	4599834.8
8	2	Plazhi i Gjirit të Lalzit	375853.2	4595326.2
9	1	Plazhi Rrushkull	374321.0	4591441.4
10	2	Plazhi Rrushkull	372072.4	4588931.1
11	1	Plazhi Hamallaj	374338.0	4591460.6
12	2	Plazhi Hamallaj	375849.7	4595184.3
13	1	Plazhi i Katundit të Ri	370430.8	4587524.8
14	2	Plazhi i Katundit të Ri	369312.8	4585230.5
15	1	Plazhi Currila 4	368160.8	4575841.6
16	2	Plazhi Currila 4	368286.0	4575796.8
17	1	Plazhi Currila 5	368562.9	4575627.2
18	2	Plazhi Currila 5	369148.3	4574403.5
19	1	Plazhi i Durrësit	371942.3	4574789.1
20	2	Plazhi i Durrësit	375118.5	4571538.4
21	1	Plazhi i Rrashbullit	375146.6	4571493.0
22	2	Plazhi i Rrashbullit	375893.9	4569375.4
23	1	Plazhi Golem	375294.3	4565378.1
24	2	Plazhi Golem	375894.0	4569372.8
25	1	Plazhi Qerret	375287.2	4565355.7
26	2	Plazhi Qerret	374498.9	4563812.6
27	1	Plazhi i Gjeneralit	369756.5	4554319.0
28	2	Plazhi i Gjeneralit	369791.5	4553998.3
29	1	Plazhi i Spillesë	370445.5	4551020.2
30	2	Plazhi i Spillesë	370152.4	4546821.9
31	1	Plazhi i Divjakës	370553.4	4534447.9
32	2	Plazhi i Divjakës	371563.5	4537884.2
33	1	Plazhi Seman 1	362890.3	4516306.7



34	2	Plazhi Seman 1	362458.5	4513614.3
35	1	Plazhi Pishë Pore	361823.5	4508305.7
36	2	Plazhi Pishë Pore	359778.8	45 04794.1
37	1	Plazhi i Vjetër	369005.7	4480957.0
38	2	Plazhi i Vjetër	371180.7	4479083.2
39	1	Plazhi Uji i Ftohtë–Jonufër	372105.0	4476475.8
40	2	Plazhi Uji i Ftohtë–Jonufër	371166.5	4474953.1
41	1	Plazhi Radhimë	371148.6	4474918.9
42	2	Plazhi Radhimë	370671.9	4466830.0
43	1	Plazhi Oriku 1	370053.4	4466737.2
44	2	Plazhi Oriku 1	369827.6	4466152.3
45	1	Plazhi Oriku 2	369620.3	4465825.4
46	2	Plazhi Oriku 2	368424.2	4465040.1
47	1	Plazhi Dhërmi 1	380819.1	4446370.5
48	2	Plazhi Dhërmi 1	382245.6	4445277.0
49	1	Plazhi Dhërmi 1	383515.4	4444663.4
50	2	Plazhi Dhërmi 1	384798.2	4443596.0
51	1	Plazhi Jalë	389262.8	4441956.3
52	2	Plazhi Jalë	389343.9	4441662.5
53	1	Plazhi Livadh	390844.8	4440733.9
54	2	Plazhi Livadh	391799.3	4439995.6
55	1	Plazhi Himarë 1	392739.1	4439727.7
56	2	Plazhi Himarë 1	393235.6	4439596.7
57	1	Plazhi Himarë 1	393311.1	4439565.1
58	2	Plazhi Himarë 1	393440.1	4439449.7
59	1	Plazhi Potam	393545.8	4439460.1
60	2	Plazhi Potam	393805.5	4438592.9
61	1	Plazhi Lllaman	394788.7	4437450.6
62	2	Plazhi Lllaman	394929.4	4437342.9
63	1	Plazhi Qeparo 1	398744.6	4434141.7
64	2	Plazhi i Qeparo 1	399112.7	4434200.2
65	1	Plazhi i Qeparo 2	399298.0	4434252.8
66	2	Plazhi i Qeparo 2	400227.1	4434147.6
67	1	Plazhi i Borshit	400741.8	4434121.2
68	2	Plazhi i Borshit	404018.4	4431075.3
69	1	Plazhi i Bunecit	405206.0	4429134.7
70	2	Plazhi i Bunecit	405529.7	4428420.1
71	1	Plazhi Lukovë 1	406304.4	4426931.1
72	2	Plazhi Lukovë 1	406373.8	4426482.0
73	1	Plazhi Lukovë 1	407100.8	4425709.5
74	2	Plazhi Lukovë 1	407167.4	4425503.3
75	1	Plazhi Lukovë 1	407187.5	4425443.2
76	2	Plazhi Lukovë 1	407205.2	4425011.7
77	1	Plazhi Kakome	409307.5	4420300.9
78	2	Plazhi Kakome	409171.0	4420034.4
79	1	Plazhi Sarandë 1	414695.6	4413704.8
80	2	Plazhi Sarandë 1	413713.9	4413973.7
81	1	Plazhi Sarandë 1	415070.0	4414162.5
82	2	Plazhi Sarandë 1	414771.7	4414063.3
83	1	Plazhi Sarandë 1	415648.2	4413986.6
84	2	Plazhi Sarandë 1	415270.9	4414206.7
85	1	Plazhi Sarandë 1	415728.6	4413587.0



86	2	Plazhi Sarandë 1	415681.5	4413871.7
87	1	Plazhi Sarandë 1	415819.1	4413446.0
88	2	Plazhi Sarandë 1	415851.7	4413402.3
89	1	Plazhi Sarandë 1	415995.4	4413029.4
90	2	Plazhi Sarandë 1	415894.6	4413084.2
91	1	Plazhi Sarandë 1	416204.8	4411937.1
92	2	Plazhi Sarandë 1	416143.4	4412184.7
93	1	Plazhi Sarandë 1	416267.2	4411903.2
94	2	Plazhi Sarandë 1	416213.2	4411702.1
95		Pasqyrat (Ksamil)	414834.6	4406480.3
96		Pulëbardhat (Ksamil)	414519.2	4406125.2
97		Gjiri i Hartës (Ksamil)	414557.9	4405252.6
98		Gjiri i Baxhos (Ksamil 1)	415011.0	4403729.1
99		Plazhi (Ksamil 2)	414510.5	4403212.9
100		Gjiri Poda (Ksamil 3)	414539.9	4403000.6
101		Plazhi i Guvave (Ksamil 4)	414262.9	4403032.7
102		Plazhi 4 Ishujt (Ksamil 5)	414106.8	4403065.5
103		Plazhi Gjiri Bora-Bora (Ksamil 6)	414243.2	4402837.2
104		Plazhi i Ksamilit (Ksamil 7)	414222.6	4402474.2
105		Gjiri i Varkave (Ksamil 8)	413965.4	4402244.5
106		Plazhi i Palasës	380519.5	4446522.5
107		Plazhi i Rrugëve të Bardha	379468.5	4447499.0
108		Plazhi i Pogradecit	471637.2	4527954.3
109		Plazhi i Nartës	366928.3	4483720.0

SHTOJCA 2

KONTRATA MODEL PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS SË PLAZHIT KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë [•], në [•], nënshkruhet kjo kontratë qiraje (“**Kontrata**”) ndërmjet palëve, si më poshtë:

Bashkia [•], përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e kryetarit të Bashkisë (“**Qiradhënësi**”)

dhe

[•], një shoqëri [•]/person fizik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi [•], me seli në adresën: [•], përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e përfaqësuesit ligjor (“**Qiramarrësi**”).

Këtu e më poshtë, së bashku, referuar si “**Palët**” dhe veç e veç si “**Pala**”.

MEQENËSE:

A) Qiramarrësi operon një strukturë akomoduese/restorant të ndodhur në [•], me një kapacitet prej [•] (nëse aplikohet);

B) Mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë

së stacionit të plazhit’”, qiramarrësi ka depozituar pranë qiradhënësit, në datën [•], aplikimin për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m², të ndodhur në [•];

C) Qiradhënësi, mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, ka njoftuar, në datën [•], qiramarrësin për miratimin e kërkesës për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m² të ndodhur në [•].

Për sa më sipër dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, palët bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e hapësirës së plazhit të ndodhur në [•], me sipërfaqe prej [•] m², në administrim të qiradhënësit, sipas hartës bashkëngjitur, si shtojca 1 e kontratës.



Neni 2

Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë prej [•] vitesh, me të drejtë përdorimi, të paktën për periudhën 1 maj – 30 shtator të çdo viti, të përcaktuar në këtë nen.

2. Palët bien dakord që kontrata do të përfundojë me përfundimin e afatit dhe nuk do të rinovohet automatikisht pa miratimin me shkrim të qiradhënësit.

3. Të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të afatit, qiramarrësi i dërgon qiradhënësit një kërkesë për rinovimin e kontratës, duke shoqëruar kërkesën e tij me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 12, të rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, në lidhje me zbatimin e rregullt të kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.

4. Qiradhënësi miraton/refuzon kërkesën e qiramarrësit për rinovimin e kontratës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

1. Qiradhënësi dorëzon, brenda [•] ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, hapësirën e plazhit të përcaktuar në pikën 1, të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të hapësirës së plazhit që jepet me qira, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

2. Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit.

3. Qiradhënësi është i detyruar të garantojë qiramarrësin për gëzimin e qetë të hapësirës së

plazhit, objekt të kontratës gjatë gjithë periudhës së qirasë. Ai garanton qiramarrësin nga çdo pretendim apo të drejta nga palë të tjera në përdorimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt qiraje.

4. Qiradhënësi është përgjegjës për sigurimin e infrastrukturës rrugore që lidhet me plazhin, ujin e pijshëm dhe kanalizimet, si dhe për heqjen e mbeturinave, pastrimin e leshterikëve dhe menaxhimin e mbetjeve në zonat e plazhit të lira për përdorim publik.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

1. Qiramarrësi ka të drejtë të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

2. Qiramarrësi detyrohet që:

2.1 të përdorë hapësirën e plazhit, objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2;

2.2 të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me planin e biznesit të paraqitur në aplikimin pranë qiradhënësit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate;

2.3 të plotësojë e të respektojë kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ ”, si dhe në rregulloren e detajuar të stacionit të plazhit bashkëngjitur, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3. Qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë. Për çdo ditë vonese do të paguajë një kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.

4. Qiramarrësi detyrohet të bashkëpunojë me çdo autoritet publik përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e plazhit e të veprimtarive turistike, si dhe t’u japë atyre akses në të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse.

5. Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te qiradhënësi dokumentacionin e monitorimit nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe vërtetimin nga inspektorati përgjegjës për përmbushjen e kriterëve



dhe standardeve minimale për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.

6. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nënqira hapësirën e plazhit të marrë me qira sipas kontratës.

7. Qiramarrësi detyrohet të ketë të punësuar vrotues plazhi përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së plazhit.

8. Qiramarrësi detyrohet të afishojë certifikatën e kualifikimit të vrotuesit të plazhit ose kopja e saj, së bashku me NIPT-in dhe lejet që ai disponon.

Neni 6

Pagesa e qirasë

1. Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit qiranë mujore në vlerën prej [•] ([•]) lekë/muaj.

2. Pagesa e qirasë do të bëhet në llogarinë bankare të qiradhënësit nr. [•], pranë bankës [•], brenda datës [•] të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga qiradhënësi, me emërtimin "Pagesa e qirasë për muajin [•], nga shoqëria [•], për përdorimin e hapësirës së plazhit prej [•] m²".

3. Para nënshkrimit të kontratës, qiramarrësi ka paguar garancinë e kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e 1 (një) muaji të qirasë, sipas faturës së lëshuar nga qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse të qiradhënësit, deri në përfundimin e kësaj kontrate.

4. Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba e kamatëvonesa), qiramarrësi do të likuideojë vlerat e krijuara në llogarinë e qiradhënësit sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

5. Pagesa e qirasë fillon me marrjen në dorëzim të objektit.

Neni 7

Penalitetet

1. Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", si dhe në rregulloren e stacionit të plazhit bashkëngjitur, si shtojca 4, qiradhënësi do t'i dërgojë qiramarrësit një njoftim për marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

2. Nëse qiramarrësi nuk i ka përmbushur kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të

plazhit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga njoftimi, qiramarrësi do të paguajë një penalitet prej [•] % të vlerës së qirasë në ditë, duke filluar nga data e dërgimit të njoftimit sipas pikës 1, të këtij neni.

3. Në rast se konstatohet që masat për përmbushjen e detyrimeve vazhdojnë të mos realizohen nga qiramarrësi, qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë kontratën për mospërmbushje të detyrimit kontraktor dhe qiramarrësi detyrohet të paguajë penalitet në vlerën e garancisë së ngurtësuar, sipas përcaktimit në pikën 3, të nenit 6, të kësaj kontrate.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3.1, të kontratës.

2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit;

c) kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër sipas kontratës dhe kriteret e standardet e parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'".

Në rastet e lartpërmendura, kontrata do të zgjidhet me përfundimin e afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e dërgimit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës.

3. Kontrata mund të zgjidhet nga qiradhënësi edhe për shkaqe të interesit publik. Në rastin kur shkaqet e interesit publik prekin vetëm një pjesë të hapësirës së dhënë për përdorim, atëherë kontrata do të ndryshohet duke reduktuar hapësirën e duke rimbursuar qiramarrësin për pagesën e kryer lidhur me hapësirën e hequr. Në rast se për shkaqe të interesit publik është e nevojshme zgjidhja e kontratës, qiramarrësi ka të drejtën e rimbursimit të pagesës së kryer për afatin e mbetur, si dhe të drejtën e përparësisë, në kushte të barabarta, për dhënien e kontratës në një zonë të re.

4. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit me shkrim të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara.



5. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi duhet të kthejë hapësirën e plazhit në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim; në të kundërt, detyrohet të kryejë të gjitha rregullimet me shpenzimet e veta ose të paguajë vlerën përkatëse të shpenzimeve të përcaktuara me një ekspert të emëruar me marrëveshje dypalëshe.

6. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga hapësira e plazhit, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve të kryera nga qiramarrësi.

Neni 9

Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil dhe vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'".

2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve lidhur me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim midis palëve.

3. Pjesë të kësaj kontrate janë:

Shtojca 1. Harta e hapësirës së plazhit të dhënë me qira;

Shtojca 2. Planbiznesi i depozituar me aplikimin për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit;

Shtojca 3. Procesverbali i marrjes në dorëzim të hapësirës së plazhit, sipas kontratës;

Shtojca 4. Rregullorja e detajuar e stacionit të plazhit.

Shtojca 5. Formulari i vetëdeklarimit të plotësuar nga ana e subjektit që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e stacionit të plazhit".

4. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me kontratën apo ndonjë marrëveshje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e kontratës, do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim; në të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse.

5. Kontrata është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

(Për qiradhënësin)

(Kryetar)

(Për qiramarrësin)

(Administrator)

SHTOJCA 3

1. Pika e vrojtimit duhet të ketë këto pajisje:

- një barelë pluskuese shpëtimi;
- 2 kamerdare rrethshpëtimi 63 = cm me litar pluskues 15–25 m të gjatë;
- një bovë *baywatch*;
- një palë dylbi;
- një megafon;
- bilbil plastik;
- një rul statik me jo më pak se 200 m litar pluskues të gjatë në të;
- një mjet pluskues shpëtimi (*surf board* ose pedalon).

f) kutia e ndihmës së shpejtë mjekësore (2 bombola oksigjeni mbi 1 L, 150 atm, me reduktor presioni me manometër kontrolli, pompë dore oksigjenimi, hapëse goje, *poker mask*, aparat matës tensioni, ampulë adrenaline, kollare qafë, shiringë sterile, termometër, doreza higjienike njëpërdorimëshe (5 copë), 1 flakon dezinfektant me betadinë, 3 flakonë solucioni fiziologjik (*chlorur sodium* - 0.9%) 500 ml, 10 garza sterile 10x10, 2 garza sterile 18x40, 2 peceta sterile njëpërdorimëshe, 2 pinca sterilë njëpërdorimësh, fashë llastiku e masës mesatare, pambuk absorbues, 2 leukoplastë të madhësive të ndryshme, 2 rrole leukoplasti me gjerësi 2.5cm, gërshërë, 3 llastikë hemostatikë, akull i gatshëm, qese higjienike njëpërdorimëshe).

Artikujt e kutisë së ndihmës mjekësore duhet të jenë brenda standardeve dhe afateve të përdorimit. Nuk duhet të ekspozohen ndaj diellit dhe temperaturave të larta.

SHTOJCA 4

Kulla e vrojtimit duhet të ketë këto pajisje:

- 1 barelë pluskuese shpëtimi;
- 2 kamerdare rrethshpëtimi d = 63 cm me litar pluskues 15–25 m të gjatë;
- 1 bovë *baywatch* për çdo vrojtues në shërbim;
- 1 palë dylbi;
- 1 megafon;
- bilbil plastik për çdo vrojtues në shërbim;
- 1 rul lëvizës (me jo më pak se 200 m litar pluskues të gjatë);
- 1 mjet pluskues shpëtimi (*surf board* ose pedalon) me shenja dalluese për përdorim shpëtimi, i cili nuk mund të përdoret për arsye të tjera, nga persona të paautorizuar;



f) kutia e ndihmës së shpejtë mjekësore (2 bombola oksigjeni mbi 1 L, 150 atm, me reduktor presioni me manometër kontrolli, pompë dore oksigjenimi, hapëse goje, *poker mask*, aparat matës tensioni, ampulë adrenaline, kollare qafe, shiringë sterile, termometër, doreza higjienike njëpërdorimëshe (5 copë), 1 flakon dezinfektant me betadinë, 3 flakonë solucioni fiziologjik (*chlour sodium* - 0.9%) 500 ml, 10 garza sterile 10x10, 2 garza sterile 18x40, 2 peceta sterile njëpërdorimëshe, 2 pinca sterile njëpërdorimësh, fashë llastiku e masës mesatare, pambuk absorbues, 2 leukoplastë të madhësive të ndryshme, 2 rrole leukoplasti me gjerësi 2.5 cm, gërshërë, 3 llastikë hemostatikë, akull i gatshëm, qese higjienike njëpërdorimëshe).

Artikujt e kutisë së ndihmës mjekësore duhet të jenë brenda standardeve dhe afateve të përdorimit. Nuk duhet të ekspozohen ndaj diellit dhe temperaturave të larta.

SHTOJCA 5 VETËDEKLARIM

Në respektim të ligjit nr. 114/2017, “Për turizmin”, si dhe të vendimit nr. ___, datë __. __. ___, të Këshillit të Ministrave, “___”, unë, i nënshkruari, _____ deklaroj se jam njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mbaj përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Jam përgjegjës për, si më poshtë vijon:

- ☐ Krijimin e kushteve higjienike;
- ☐ Respektimin e hapësirave të vendosjes së çadrave sipas tipologjisë së plazhit;
- ☐ Vendosjen e sinjalistikës në stacionin e plazhit dhe kufizimin me bova të hapësirës ujore të dedikuar për not;
- ☐ Sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim;
- ☐ Garantimin e sigurisë së jetës me vrojtues plazhi, përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së plazhit;
- ☐ Mirëmbajtjen e mjeteve dhe ambienteve të ndihmës së parë mjekësore;
- ☐ Afishimin e kanaleve për komunikim emergjence.

Mosplotësimi i kushteve dhe kriterëve ngarkon me përgjegjësi administrative dhe/apo, kur është rasti, me përgjegjësi penale kur sjell pasoja të rënda për shëndetin.

ADMINISTRATORI

UDHËZIM

Nr. 2, datë 2.4.2019

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”,

UDHËZOJ:

1. Zbatimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve”, sipas lidhjes 1 dhe lidhjes 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizime.

3. Udhëzimi nr. 665, datë 4.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 837, datë 10.2.2017, të ministrit të transportit dhe infrastrukturës, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku



Lidhja 1

METODOLOGJI**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE**

Kjo metodologji është hartuar në zbatim të VKM-së nr. 431, datë 11.7.2018 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, pika 13, germa “dh”, dhe në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.

Detajimi i fondit të subvencionit për çdo shoqëri aksionere të ujësjellës-kanalizimeve (sh.a. UK) dhe përdorimi i tij, do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet dhe përdoret nga AKUM-i në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor:

a) subvencione, me llogari ekonomike (603), me kod produkti 90611AB;

b) Reforma e ujit, me llogari ekonomike (231), me kod produkti 18BQ607, si dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me VKM.

2. Vlerësimi i nevojave për subvencione, si dhe detajimi dhe shpërndarja e subvencionit nga AKUM-i, do të bazohet në:

a) të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve sh.a. UK, pranë AKUM-it, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara.

b) në ecurinë e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në kontratat e performancës, lidhur ndërmjet palëve (AKUM - bashkisë përkatëse).

3. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1.a. të kësaj metodologjie, zëri subvencione (603), me kod produkti 90611AB, do të përdoret nga AKUM-i, vetëm për shoqëritë që kanë nënshkruar kontratat e performancës, si më poshtë:

a) Për të përballuar mbulimin e kostos direkte të operimit (KDO), diferencën = të ardhura të faturuara të sh.a. UK&ITUN – kosto direkte e operimit.

Kostos Direkte të Operimit përlllogariten si kosto totale e operimit, duke zbritur amortizimin, për të tria shërbimet publike, furnizim me ujë të pijshëm; kanalizime; trajtim e përpunim të ujërave të ndotura.

Në çdo rast, diferenca e të ardhura të sh.a. UK –

kosto direkte e operimit, duhet të jetë negative.

Prioritet në ndarjen e fondit do të kenë ato ndërmarrje të cilat e kanë më të lartë koston e energjisë në raport me KDO-në, si dhe ato ndërmarrje që kanë marrë më shume pikë në analizën e performancës sipas formulës bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në ndarjen e fondit kriteri i kostos së energjisë në raport me KDO-në dhe kriteri i performancës do të kenë peshë të barabarte në masën 50% secila.

AKUM-i bën analizën dhe përlllogaritjet përkatëse për secilën nga sh.a. UK:

b) Për të përballuar efektet financiare në zbatim të VKM-së nr. 18, datë 12.1.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe vendosjen e matësve për kategoritë në nevojë”.

AKUM-i vlerëson dokumentacioni e paraqitur dhe bën shpërndarjen e subvencionit, sipas kërkesave të paraqitura.

4. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1/b të kësaj metodologjie, zëri reforma e ujit (231), me kod produkti 18BQ607, do të përdoret:

a) Për të mbështetur dhe nxitur përmirësimin e performancës së sh.a. UK që operojnë në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

b) Për të mbështetur sh.a. UK, të cilat e kanë të pamundur operimin optimal, pavarësisht përmbushjes së kriterëve të performancës.

5. Fondi që do të përdoret sipas pikës 4/a, do të shkojë për shpërblimin dhe mbështetjen e performancës së sh.a. UK, pavarësisht diferencës së kostos, bazuar në:

a) Pikët e arritura nga vlerësimi i treguesve të performancës së tyre në krahasim me objektivat.

b) Në numrin e popullsisë së shërbyer.

Për efekt të kësaj pike, AKUM-i klasifikon shoqëritë sipas performancës dhe aplikon formulën e parashikuar në lidhjen 2, të këtij udhëzimi.

6. Fondi që do të përdoret sipas pikës 4/b, do të shkojë për investime që do të ndikojnë në përmbushjen e objektivave të shoqërive, bazuar në analizën që AKUM-i bën mbi indikatorët, që ndikojnë në mosrealizimin e këtyre objektivave.

7. Përjashtohen nga përfitimi i subvencioneve sipas përcaktimit të bërë në pikën 4/a të kësaj metodologjie, sh.a. UK, në rastet kur:

a) Nuk kanë të firmosur marrëveshjen e performancës midis AKUM-it dhe njësisë së qeverisjes vendore përkatëse;

b) Nuk kanë dërguar të dhëna, ose të dhënat



nuk janë të sakta për vlerësimin e performancës së tyre sipas formatit të kërkuar nga AKUM-i.

8. Subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit, sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, do të përdoret sipas përcaktimeve si më poshtë:

a) Në rastin kur fondi i subvencionit është dhënë me destinacion mbulimin e KDO-së, sipas pikës 3.a., ai do të përdoret nga sh.a. UK për blerje klori si dhe për të paguar faturat e energjisë elektrike.

b) Në rastin e përfitimit të subvencionit, për të mbështetur dhe nxitur përmirësimin e performancës së sh.a. UK, sipas pikës 4/a, të kësaj metodologjie, fondi përdoret nga sh.a. UK, sipas prioriteteve, të listuara më poshtë:

i. për pajisjen me matës prodhimi dhe aparate klorifikimi;

ii. për pajisjen me matës konsumi;

iii. për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet;

iv. për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet kapitale të aseteve që zakonisht mbulohen nga vlera e amortizimit, pa tejkaluar vlerën e tij në koston e vitit;

v. për financimin e projekteve të zbatimit, studimeve të fizibilitetit apo detyrave të projektimit për ujësjellës kanalizime apo/dhe ITUN;

vi. për blerjen e makinerive, pajisjeve që ndihmojnë sh.a. UK në realizimin e objektivave, sipas biznesit planit të miratuar.

9. AKUM-i, brenda muajit maj, gusht, nëntor, shkurt, të çdo viti i dërgon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën renditjen e shoqërive sipas performancës.

10. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën, e cila bën çeljen e fondit të subvencioneve për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ushtron kontrolle periodike për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar, për çdo ofrues shërbimi apo shoqëri që ka përfituar nga skema e subvencionimit.

Lidhja 2

Formula që do të përdoret për shpërndarjen e fondit për performancë

$V \cdot P_n \cdot K_p1 \cdot K_p2 = S_b$ (subvencioni)

V = shuma lekë/banorë

P_n = Popullsia e shërbyer

K_p1 = koeficienti i realizimit të performancës

K_p2 = koeficienti rregullator ose korrigjues i fondit

VENDIM

Nr. 5, datë 2.4.2019

PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229 dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky vendim përcakton rregulla më të hollësishme lidhur me:

a) kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve;

b) veprimet përgatitore dhe procedurat që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*Këshilli*) zhvillon për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për pozicionet vakante për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe për inspektorë të lartë të drejtësisë.

2. Përcaktimi në këtë vendim i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe inspektorë të lartë të drejtësisë, si edhe mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit e të renditjes së kandidatëve, kanë për qëllim realizimin e kësaj procedure duke u bazuar në meritat e kandidatëve dhe duke respektuar procesin e rregullt ligjor, si edhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative.

II. Kriteret e vlerësimit të kandidatëve, pesha specifike dhe pikëzimi i tyre

3. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 125, të Kushtetutës dhe në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuar, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të



vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016.

4. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bëhet duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuara në nenin 147/d të Kushtetutës dhe në nenet 199 e 201, të ligjit nr. 115/2016, të plotësuar me kriteret e parashikuara nga neni 240, i këtij ligji.

5. Detajimi i mëtejshëm i të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimi më i hollësishëm i peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve bëhet në këtë krye, në kreun V dhe në shtojcat 1 dhe 2, të këtij vendimi.

6. Kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve klasifikohen në tri kategori:

- a) meritat profesionale;
- b) meritat morale;
- c) meritat organizative, drejtuese dhe menaxhuese.

7. Secila kategori kriteresh e treguar në pikën 6 të këtij vendimi përfshin, në radhë të parë, kriteret e posaçme ligjore të vlerësimit, të plotësuar me kriteret e tjera të së njëjtës natyrë sipas përcaktimeve më të përgjithshme të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016.

8. Peshat specifike dhe pikëzimi maksimal i secilës kategori kriteresh të treguara në pikën 6, të këtij vendimi, bazohet në radhë të parë në rëndësinë dhe peshën që i përcaktohet kriterëve përkatëse që ato kanë në përbërje nga vetë parashikimi i tyre i posaçëm në ligjin nr. 8577/2000 ose në nenet 199 dhe 201, të ligjit nr. 115/2016, të cilat plotësohen me peshën specifike të kriterëve më të përgjithshme sipas nenit 240, të ligjit nr. 115/2016.

9. Në të njëjtën mënyrë, edhe rëndësia, peshat specifike dhe pikëzimi maksimal i secilit element të kriterit të vlerësimit bazohet në atë që rezulton nga parashikimet e posaçme të treguara në pikat 3 ose 4, të këtij vendimi, të plotësuar me parashikimet e nenit 240, të ligjit nr. 115/2016.

10. Për efekt të renditjes së kandidaturave, pikëzimi përfundimtar i kandidatit të vlerësuar është shuma e pikëve që i është përcaktuar nga vlerësimi i secilit kriter të përfshirë në të tri kategoritë e kriterëve të vlerësimit dhe pikëzimit.

11. Ndarja e kriterëve të vlerësimit në kategori, lista e kriterëve që përbëjnë secilën kategori,

pikëzimi maksimal i secilës prej tyre, si edhe burimet dokumentare dhe metoda e vlerësimit përcaktohen në mënyrë të hollësishme nga:

a) shtojca nr. 1 “Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese”;

b) shtojca nr. 2 “Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të kandidatëve për inspektorë të lartë të drejtësisë”.

12. Këshilli miraton dhe bën publike shpjegime të hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimin dhe caktimin e pikëve lidhur me secilin prej kriterëve të treguar në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, të këtij vendimi.

III. Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

A. Përgatitja dhe zhvillimi i procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

13. Në fazat e kryerjes së procedurës së verifikimit, relatori i vendit vakant realizon njëkohësisht edhe veprimet përgatitore të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së tyre nga Këshilli, fillon me thirrjen e mbledhjes, e cila zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e përfundimit të procedurave të verifikimit të të gjithë kandidatëve që kanë shprehur interesin pranë të njëjtit organ emërtese që ka shpallur vendet vakante.

15. Këshilli, duke qëndruar i mbledhur, bën vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për vendet vakante të shpallura nga i njëjti organ emërtese, jo më vonë se 10 ditë nga dita e mbledhjes.

B. Të drejtat e kandidatit

16. Kandidati ka të drejtë të përzgjedhë dhe të paraqesë pranë Këshillit dokumente që i çmon të nevojshme për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës sipas rregullave dhe kriterëve të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim.

17. Kandidati ka të drejtë të parashtrojë mendime e të dëgjohej në mbledhjen e Këshillit, mbi motivet dhe objektivat e kandidimit, cilësitë morale dhe aftësitë profesionale për t’u përzgjedhur nga organi i emërtesës, sipas rastit, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ose inspektor i lartë i drejtësisë.

18. Kandidati ka të drejtë që, në procedurën e përzgjedhjes, me kërkesën e tij, të njihet me



dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

19. Afatet në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve caktohen në ditë kalendarike.

20. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

21. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

22. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

23. Kandidati njofton menjëherë relatorin ose Këshillin, në rastet kur, për pamundësi objektive ose motive të tjera të justifikuara, nuk mund të paraqitet apo të paraqesë shpjegime dhe dokumente brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim për procedurat e përzgjedhjes së kandidaturave. Kur i vlerëson motivet e parashtruara me shkrim si të justifikuara, relatori apo Këshilli i cakton kandidatin një afat të ri të arsyeshëm.

Ç. Njoftimet

24. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatin gjatë procedurës së përzgjedhjes bëhen me shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike të deklaruara për këtë qëllim nga kandidati, pranë Këshillit ose organit të emërtesës ku ka paraqitur kandidaturën.

25. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatin drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në adresën elektronike të Këshillit, e cila i është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave.

26. Kandidati ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Këshillin për çdo ndryshim të adresës postare dhe elektronike të dekluarar.

IV. Veprimet përgatitore për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

27. Veprimet përgatitore për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve zhvillohen njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

28. Relatori ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale:

a) të komunikimit me kandidatin në lidhje me paraqitjen, pranimin dhe plotësimin e dokumenteve të nevojshme për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij vendimi;

b) të përgatitjes së dokumentacionit dhe paraqitjes së projektakteve të nevojshme për shqyrtim nga Këshilli lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve.

29. Në rastin e kandidatëve që, njëkohësisht, kanë shprehur interes për më shumë se një vend vakant në proces shqyrtimi nga Këshilli, secili nga relatorët përkatës të vendeve vakante:

a) administron kopje të plotë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve;

b) njofton kandidatin për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar dokumentet e paraqitura, në rastet kur vlerëson se janë me mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit;

c) njofton menjëherë relatorët e tjerë të vendeve vakante për veprimin procedural të kryer sipas shkronjës “b”, të kësaj pike, si edhe i përcjell atyre shpjegimet dhe dokumentet përkatëse të paraqitura nga kandidati sipas kësaj procedure;

ç) përgatit dhe paraqit për shqyrtim në Këshill relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve dhe përmbledhjen faktike të tyre për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatin, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit.

30. Në kryerjen e detyrës, relatori mbështetet nga këshilltarët ligjorë dhe personeli administrativ i Gjykatës së Lartë, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.



31. Brenda 15 ditëve nga ajo e paraqitjes në zyrën e posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë për të kryer veprimet e parashikuara nga pika 22 e vendimit nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kandidati dorëzon pranë kësaj zyre dokumentet e nevojshme për përzgjedhjen, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve sipas përcaktimeve të ligjit dhe të këtij vendimi.

32. Lista e dokumenteve që kandidati dorëzon në kopje origjinale ose të vërtetuar sipas ligjit përfshin:

a) jetëshkrimin e përditësuar me të dhënat deri në kohën e dorëzimit sipas pikës 31 të këtij vendimi, të hartuar sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli;

b) dokumentin që përshkruan motivimin e kandidimit dhe objektivat nëse emërohet;

c) pesë dokumente profesionale të përzgjedhura nga vetë kandidati për vlerësim sipas metodologjisë profesionale të miratuar nga Këshilli;

ç) dokumente të tjerë që shërbejnë për vlerësimin e kandidatit, sipas përcaktimeve orientuese në shtojcën nr. 1 ose shtojcën nr. 2 të këtij vendimi, në zërin “Burimet e vlerësimit”, për secilën kategori dhe kriter të vlerësimit;

d) deklarin, nëse zotëron, të njohurive në gjuhë të huaja, të shoqëruar nëse i disponon me dokumente përkatëse vërtetuese të lëshuar nga subjekte publike ose private të specializuara.

33. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, relatori vlerëson se ka mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar mangësitë e dokumentit të paraqitur.

34. Mungesa e përgjigjes së kandidatit për dhënien e shpjegimeve dhe për saktësimin ose plotësimin e mangësive për dokumentet e paraqitur nuk pengon vijimin e veprimeve përgatitore të relatorit për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit.

35. Njëkohësisht, ose menjëherë pas përgjigjes së dhënë nga kandidati sipas pikës 33 të këtij vendimi, si edhe kur vjen në dijeni, për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në dokumente të paraqitura nga kandidati, relatori mund të kërkojë

nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, shpjegime, të dhëna apo kopje të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.

36. Pas kryerjes së veprimeve përgatitore të parashikuara në pikat 31 deri 35 të këtij vendimi dhe duke u bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në ligj, të detajuara në këtë vendim dhe në shtojcat e tij, relatori:

a) shqyrton dhe përgatit dokumentacionin e secilit kandidat për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës;

b) përgatit relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve të paraqitura nga kandidati apo të ardhura nga subjekte publike a private mbi kërkesën e relatorit, përmbledhjen faktike të përmbajtjes së këtyre dokumenteve për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit.

37. Veprimet përgatitore për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit ndërpriten në rastin kur Këshilli vendos urdhërimin e ndalimit të kandidimit.

38. Në përfundim të procedurave të verifikimit të të gjithë kandidatëve për vendin vakant, relatori njofton kryetarin dhe i paraqet për shqyrtim Këshillit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave.

V. Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve

A. Thirrja e mbledhjes për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

39. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit të relatorit të vendit vakant për përfundimin e procedurave të verifikimit, thërret mbledhjen e Këshillit për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e njoftimit të relatorit.

40. Në rast se Këshilli ka për shqyrtim, njëkohësisht, procedurat e verifikimit dhe përzgjedhjes të kandidatëve për më shumë se një vend vakant në Gjykatën Kushtetuese e që i përkasin të njëjtit organ emërtese, mbledhja e Këshillit thirret dhe zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e njoftimit më të fundit nga relatorët për



përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve të të gjitha këtyre vendeve vakante.

41. Mbledhja e Këshillit për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve është e vlefshme nëse marrin pjesë së paku 5 anëtarë të tij.

42. Në mbledhjen e Këshillit për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve marrin pjesë anëtarët. Gjithashtu, marrin pjesë Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e subjekteve që ftohen sipas ligjit, mosparaqitja e të cilëve nuk përbën shkak për shtyrjen e mbledhjes.

B. Seanca e parë e mbledhjes për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve

43. Dita dhe koha e zhvillimit të seancës së parë të mbledhjes së Këshillit i njoftohet Avokatit të Popullit dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhje sipas ligjit. Avokatit të Popullit i dërgohet edhe relacioni mbi veprimet përgatitore të kryera dhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori për shqyrtim në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

44. Në seancën e parë të mbledhjes për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, Këshilli vendos për çështje që lidhen me procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore dhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim, përcaktimin e kalendarit të intervistave me kandidatët dhe përcaktimin e listës së ekspertëve që mund të jetë e nevojshme të thirren për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja të deklaruara prej tyre.

45. Në këtë mbledhje, Këshilli vendos pasi dëgjon parashtrimet dhe propozimet e relatorëve, sqarimet e tyre mbi pyetjet e anëtarëve, si edhe mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatëve.

46. Bisedimet e çështjeve, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të Këshillit.

47. Në përfundim të bisedimeve, për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori, i pasuar nga Kryetari dhe me radhë nga anëtarët e tjerë, sipas renditjes së përbërjes së Këshillit që rezulton nga përzgjedhja me short e anëtarëve nga Presidenti apo Kuvendi.

48. Vendimet e Këshillit lidhur me çështjet e përcaktuara në pikën 44 të këtij vendimi, merren

me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit. Abstenimi nuk lejohet.

49. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtarë, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin. Vendimi bëhet menjëherë publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

C. Seancat e mbledhjes për intervistat me kandidatët

50. Kandidati njoftohet për vendin, ditën dhe kohën e paraqitjes për intervistë në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës.

51. Këshilli njofton ekspertët për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet e Këshillit lidhur me natyrën e shërbimit të kërkuar.

52. Nëse kandidati ka deklaruar zotërimin e gjuhëve të huaja dhe Këshilli ka vendosur të vlerësojë me shkallën e zotërimit, eksperti i thirrur për këtë qëllim bisedon dhe i drejton pyetje kandidatit gjatë procedurës së intervistës, shqyrton dokumente me shkrim në gjuhë të huaj të paraqitur nga vetë kandidatët, si dhe përgatit mendimin me shkrim për shkallën e zotërimit të gjuhës së huaja.

53. Në ditën dhe kohën e paracaktuar, pas deklarimit të hapjes së seancës, Këshilli verifikon paraqitjen e ekspertëve, u kujton atyre rëndësinë e detyrës për të cilën janë thirrur dhe i fton të bëjnë betimin se do të kryejnë me profesionalizëm dhe me nder detyrën që u është besuar.

54. Pas betimit, ekspertëve u njoftohen kandidatët që kanë deklaruar se zotërojnë njohuri në gjuhë të huaja për të cilët Këshilli vlerëson të nevojshëm mendimin e ekspertit dhe u kërkohet të shprehën nëse janë në kushte papajtueshmërie apo konflikti interesi me ta.

55. Këshilli thërret për intervistë kandidatët sipas programit të miratuar paraprakisht me vendim në seancën e parë të mbledhjes së tij.

56. Kandidati pyetet fillimisht nëse ka pretendime për gjendje papajtueshmërie a konflikti interesi me anëtarë të Këshillit, pjesëmarrës të tjerë në mbledhje dhe me ekspertët.

57. Pas orientimit për mënyrën e zhvillimit të intervistës dhe kohëzgjatjen e saj, kandidati ftohet për parashtrimin e lirë të motiveve dhe arsyeve të



kandidimit dhe objektivave që synon të ndjekë nëse emërohet në detyrë nga organi i emërtesës.

58. Intervista vijon me pyetje të anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet e kandidatit.

59. Ekspertët e thirrur nga Këshilli bisedojnë me kandidatin, në gjuhët e huaja të deklaruara, për çështje të natyrës së përgjithshme dhe të fushës profesionale.

60. Brenda afatit që i caktohet nga Këshilli, ekspertët hartojnë mendimin me shkrim për shkallën e zotërimit të gjuhëve të huaja nga kandidati, sipas kriterëve dhe mënyrës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën nr. 1 ose shtojcën nr. 2 të këtij vendimi dhe në metodologjinë e miratuar nga Këshilli për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturave.

Ç. Bisedimet e Këshillit për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve

61. Në përfundim të seancave të mbledhjes për intervistat e të gjithë kandidatëve për vendin vakant ose për vendet vakante të shpallura nga i njëjti organ emërtese, Këshilli vijon me bisedimin për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

62. Bisedimet e çështjeve për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, votimi i vendimit për listat përfundimtare të renditjes së tyre si edhe i raportit përkatës arsyetues bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të Këshillit që marrin pjesë në mbledhje.

63. Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj dhe në rregullat e detajuara të këtij vendimi e të shtojcave bashkëlidhur. Ky vlerësim mbështetet në dokumentacionin e paraqitur dhe intervistat e realizuara me secilin kandidat.

64. Renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në rezultatin e pikëzimit për secilin kandidat që rezulton nga pjesëtimi i shumës së pikëve totale të caktuara nga të gjithë anëtarët e Këshillit me numrin e anëtarëve.

65. Në rast të barazisë së pikëve mes kandidatëve, renditja përcaktohet nga rezultati i pikëve të dhëna për kategorinë “Merita profesionale” dhe, nëse rezulton përsëri barazi në pikë, nga rezultati i pikëve për kriterin “vjetërsia në profesion”.

66. Këshilli vlerëson meritat dhe bën pikëzimin e secilit kandidat. Relatori diskuton e parashtron i pari arsyetimin mbi vlerësimin e meritave të kandidatit dhe pikëzimin për secilin kriter, i pasuar nga Kryetari dhe me radhë nga anëtarët e tjerë,

sipas renditjes së përbërjes së Këshillit që rezulton nga për zgjedhja me short e anëtarëve nga Presidenti apo Kuvendi. Abstenimi nuk lejohet.

67. Në përfundim të diskutimit, relatori përgatit vendimin për vlerësimin e kandidatit ku pasqyrohet totali i pikëve të dhëna nga Këshilli sipas mbledhjes aritmetike të pikëzimit të dhënë nga të gjithë anëtarët pjesëtuar me numrin e tyre. Po, kështu, në këtë vendim pasqyrohet edhe arsyetimi lidhur me vlerësimin e Këshillit për kandidatin në lidhje me secilin prej kriterëve. Vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, i hartuar sipas kësaj pike, votohet dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që marrin pjesë në vlerësim.

68. Bazuar në pikëzimin që rezulton të jetë dhënë nga Këshilli për të gjithë kandidatët, në varësi të numrit të vendeve vakante që janë në shqyrtim dhe organit të emërtesës që i ka shpallur, relatori përgatit dhe i paraqit Këshillit listën përfundimtare që përmban renditjen e kandidatëve për secilin vend vakant.

69. Nëse Këshilli ka në shqyrtim më shumë se një vend vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga i njëjti organ emërtese, përgatiten dhe i paraqiten dy lista të veçanta që përmbajnë renditjen e kandidatëve që e kanë shprehur interesin për kandidim pranë atij organi emërtese:

a) lista që përmban vetëm kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit;

b) lista që përmban kandidatët që nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit.

70. Këshilli shqyrton listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të paraqitura nga relatori për të verifikuar:

a) saktësinë aritmetike të pikëzimit total për secilin kandidat sipas vendimeve përkatëse të vlerësimit,

b) renditjen e tyre në listat përfundimtare sipas totalit të pikëve të dhëna, si edhe kur është rasti, të kushteve të treguara në pikën 69 të këtij vendimi.

71. Krahas listës përfundimtare që përmban renditjen e kandidatëve, relatori përgatit dhe i paraqit për miratim Këshillit edhe projektraportin e arsyetuar, që shoqëron vendimin për listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, i cili i dërgohet organit të emërtesës, ku përmbahet analiza tërësore lidhur me plotësimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve ligjore për secilin



kandidat, si edhe për procedurën e ndjekur për vlerësimin dhe renditjen e tyre.

72. Aktet e përcaktuara në pikën 67, 70 dhe 71, të këtij vendimi, miratohen me shumicën e votave e të gjithë anëtarëve të Këshillit. Abstenimi nuk lejohet.

73. Vendimi për pikëzimin dhe listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, si edhe raporti i arsyetuar sipas pikës 67, 70 dhe 71 të këtij vendimi, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit lidhur me këto akte ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe e nënshkruan atë.

74. Përveç rastit kur ka mbetur në pakicë, hartimi i raportit të arsyetuar sipas pikës 71 të këtij vendimi bëhet nga relatori i çështjes. Anëtari që ka mbetur në pakicë, arsyeton qëndrimin e tij, i cili i bashkohet raportit.

75. Vendimet e Këshillit për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe raportin e arsyetuar që i dërgohet organit të emërtesës, shpallen brenda afatit ligjor 10 ditë nga dita e fillimit të kësaj procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve.

76. Menjëherë pas shpalljes së tyre, Kryetari i përcjell organit të emërtesës listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe raportin e arsyetuar të Këshillit ku përmbahet analiza tërësore lidhur me plotësimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve ligjore për secilin kandidat, si edhe për procedurën e ndjekur për vlerësimin dhe renditjen e tyre.

77. Kur gjatë zhvillimit të procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, relatori përkatës i pozicionit vakant konstaton se numri i kandidatëve për atë pozicion vakant në Gjykatën Kushtetuese ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përkatësisht, zbret në më pak se 3 dhe 5 kandidatë, njofton menjëherë Kryetarin, i cili thërret mbledhjen e Këshillit për të vendosur mbi mënyrën e procedimit të mëtejshëm me atë pozicion vakant.

D. Publikimi i akteve të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve. Komunikata për median

78. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, publikohen menjëherë:

a) vendimet e arsyetuara të Këshillit për përgatitjen e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve;

b) vendimet e arsyetuara të Këshillit për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat;

c) listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe vendimet miratuese të tyre;

ç) raporti i arsyetuar që i përcillet organit të emërtesës, i cili përmban analizën e plotësimit të kushteve ligjore dhe të vlerësimit të kriterëve ligjore për secilin kandidat;

d) përmbledhje e procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen ku vendoset vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve;

dh) komunikata për median sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 233, të ligjit nr. 115/2016.

VI. Dispozita kalimtare dhe të fundit

79. Pavarësisht nga koha e kandidimit në vende vakante të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kandidatët duhet të paraqesin pranë zyrës së posaçme të Këshillit pranë Gjykatës së Lartë dokumentet e nevojshme, me të dhënat e aktualizuara, sipas parashikimeve dhe në afatin e përcaktuar në pikat 31 dhe 32, të këtij vendimi.

80. Për vendet vakante që tashmë janë krijuar në Gjykatën Kushtetuese të cilat i përkasin të njëjtit organ emërtese, pavarësisht nga përcaktimet e pikës 69 të këtij vendimi, duke mbajtur parasysh rrethanat e mungesës së njëhershme në shpalljen e vendeve vakante, të kohës së tejzgjatur ndërmjet shpalljeve të konkurrimit për plotësimin e tyre dhe ekzistencën njëkohësisht të vendeve vakante me mandat të plotë dhe të pjesshëm, për të garantuar trajtimin e aplikimeve të kandidatëve në respektim të parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe të së drejtës së tyre të zgjedhjes së kandidimit për vende vakante të plotë ose të pjesshme, Këshilli do të procedojë me paraqitjen pranë organit përkatës të emërtesës të një liste të vetme përfundimtare të renditjes së kandidatëve sipas vendit vakant ku kanë shprehur interesin për kandidim.

D. Dispozita të fundit

81. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Dvorani



SHTOJCA NR. 1
KRITERET E VLERËSIMIT DHE METODOLOGJIA E PIKËZIMIT TË KANDIDATËVE
PËR GJYQTARË NË GJYKATËN KUSHTETUESE

1.MERITAT PROFESIONALE			Totali i pikëve	Pikëzimi nga KED-i
			60	
KRITERET KUSHTETUESE DHE LIGJORE TË VLERËSIMIT	BURIMET E VLERËSIMIT (LISTË JOSHTERUESE)	INDIKATORË VLERËSUES PËR PIKËZIMIN (LISTË JOSHTERUESE)	Pikëzimi maksimal i grupit të kriterëve	Pikëzim nga KED-i
A. Historiku arsimor dhe profesional <i>Kushtetuta - neni 125(4) ligji nr. 8577/2000: neni 7/a(2)(a), 7/a(3)(d), ligji nr.115/2016: neni 240(1)(c), (ç), neni 240(4)(a), (b) dhe (c)</i>			18	
<u>Vjetërsia:</u> Neni 125 (4) i Kushtetutës Së paku 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike. Neni 7/a(2)(a) i ligjit nr. 8577/2000 Të ketë përvojë profesionale jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Neni 7/a (3)(a) i ligjit nr. 8577/2000 Vjetërsia në profesion.	Jetëshkrimi. Dokumente zyrtare mbi angazhimet në karrierën profesionale.	Kohëzgjatja e karrierës profesionale, përtej kufirit ligjor prej 15 vitesh.	4	



<u>Historiku arsimor:</u> <i>Neni 7/a(3)(d) i ligjit nr. 8577/2000</i> Ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit.... <i>Neni 240(1)(c) i ligjit nr. 115/2016</i> Rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me ecurinë e kryerjes së studimeve të ndjekura, sipas rastit nga institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete nga institucionet kompetente lidhur me dhënien e titullit akademik.	Niveli i rezultateve të arritura gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik. Lloji, profili dhe tematika të dhënies së titullit akademik. Institucioni arsimor që ka dhënë titullin.	2	
<u>Kualifikime pasuniversitare:</u> <i>Neni 7/a(3)(c) i ligjit nr. 8577/2000</i> Kualifikime pasuniversitare dhe trajnime në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës <i>Neni 7/a(3)(d) i ligjit nr. 8577/2000</i> Ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit <u>ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës.</u> <i>Neni 240(1)(ç) i ligjit nr. 115/2016</i> Ecuria në punë dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit. <i>Neni 240(4)(a) i ligjit nr. 115/2016</i> Titujt akademikë <i>Neni 240(4)(b) i ligjit nr. 115/2016</i> Kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit.	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me pjesëmarrje dhe rezultatet në: -trajnime dhe kurse profesionale; -kualifikime pasuniversitare dhe trajnime në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës; - Shkollën e Magjistraturës; - studime dhe trajnime afatgjata jashtë vendit.	Vëmendja, angazhimi dhe korrektësia e ndjekjes së veprimtarive që mundësojnë rritjen e shkallës së profesionalizimit në ushtrimin e veprimtarisë profesionale. Institucioni organizues, trajnues dhe lloji i kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve të ndjekura. Angazhimi, korrektësia dhe rezultatet e ndjekjes së studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit. Institucioni arsimor dhe trajnues, lloji i studimeve dhe trajnimeve afatgjata të ndjekura.	8	



<u>Njohja e gjuhëve të huaja:</u> <i>Neni 240(4)(c) i ligjit nr. 115/2016</i> Njohja e gjuhëve të huaja	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me certifikimin ose evidentimin e zotërimit të gjuhëve të huaja. Intervista dhe mendimi i ekspertit. Botime ose dokumente të përgatitura dhe të dorëzuara nga kandidati në gjuhën përkatëse.	Lloji, shkalla e zotërimit dhe institucioni ku është vlerësuar njohja e gjuhës së huaj.	4	
B. Kualifikimi i përgjithshëm profesional <i>Ligji nr. 115/2016: neni 240(1)(a); ligji nr. 8577/2000: neni 7/a(3)(ç)</i>			30	
<i>Neni 7/a (3)(ç) i ligjit nr. 8577/2000</i> Vlerësimi në bazë të treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike. <i>Neni 240(1)(a) i ligjit nr.115/2016</i> Rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon.	Jetëshkrimi Punime dhe dokumente profesionale të kandidatit, të përgatitura në përmbushje të funksioneve dhe veprimtarive profesionale, sipas profilit përkatës, ku përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to: vendime gjyqësore, kërkesa për gjykim, pretendca, padi, parashtrësia të mbrojtjes së çështjes, mjete të kundërshtimit të vendimeve, akte administrative dhe parashtrime në praktika administrative të përgatitura me kontribute nga kandidati, përfaqësime të ndryshme të interesave publike ose private përpara organeve të drejtësisë ose institucioneve brenda apo jashtë vendit, prezantime, artikuj dhe publikime shkencore e profesionale. Dokumente, ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë	Vlerësimi dhe identifikimi i rezultateve profesionale më të spikatura dhe më të shkëlqyera. Rezultatet e vlerësimit profesional të nxjerrë nga 5 dokumente të paraqitura dhe përzgjedhura nga vetë kandidatët si më të përshtatshmet për t'u shqyrtuar, të cilat vlerësohen nga Këshilli në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, për tregues të tillë si: - Origjinaliteti (përfshirë edhe kontrollin e plagjiaturës) dhe/ose impaktin e dokumentit; - Aftësitë analitike; - Aftësitë hulumtuese; - Saktësia dhe konciziteti; - Zhvillimi logjik i koncepteve juridike, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja; - Aftësia për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e	30	



	profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli. Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendasen ose ndërkombëtare. Statistika profesionale nga institucione kompetente.	ndryshme të së drejtës, si dhe kurajë profesionale për të treguar dhe argumentuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit; - Aftësia për të referuar dhe trajtuar me efektivitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit e qëllimit të aktit, të praktikës e konsoliduar gjyqësore, praktikës së unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, asaj të GJEDNJ-së dhe jurisprudencës në tërësi.		
C. Kualifikimi shtesë profesional <i>Kushtetuta: neni 125(4); ligji nr. 8577/2000: neni 7/a(2)(b), 7/a(3)(b); ligji nr. 115/2016: neni 240(1)(b)</i>			12	
<u>Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës</u> A. Ekspertiza në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut Neni 7/a(2)(b) i ligjit nr. 8577/2000 Të ketë një veprimtari të njohur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut [...] Neni 7/a(3)(b) i ligjit nr. 8577/2000 Përvoja e veçantë e kandidatit si Këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese[...] Neni 240(1)(b) i ligjit nr.115/2016 Vlerësimi i rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve [...] OSE B. Ekspertizë në fusha të tjera të veçanta të së drejtës Neni 7/a(2)(b) i ligjit nr. 8577/2000	Jetëshkrimi Dokumente zyrtare për angazhimin dhe rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. 5 dokumente profesionale që tregojnë fushën e specializimit, krahas cilësisë dhe arritjeve gjatë përvojave të punës, ku mund të përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, edhe dokumentet e përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli.	Rezultatet profesionale vlerësohen nga Këshilli në lidhje me rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, për të pasuruar kapacitetet profesionale të Gjykatës Kushtetuese, me profesionistë të spikatur nga fusha e së drejtës kushtetuese, e të drejtave të njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës. Lloji dhe kohëzgjatja e angazhimit të posaçëm apo të profilizuar, për fusha konkrete të së drejtës: - në veprimtari të caktuara profesionale; - në funksione institucionale, të lidhura me ushtrimin e profesionit. Në secilën nga dy nënndarjet e fushave A ose B të këtij kriteri kandidati vlerësohet deri në maksimumin prej 8 pikësh.	8	



Të ketë një veprimtari të njohur në [...] sfera të tjera të së drejtës. Neni 7/a(3)(b) i ligjit nr. 8577/2000 Përvoja e veçantë e kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i [...] Gjykatës së Lartë. Neni 240(1)(b) i ligjit nr. 115/2016 Vlerësimi i rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve [...]				
<u>Angazhime profesionale shitesë</u> Neni 240(1)(b) i ligjit nr. 115/2016 [...] pjesëmarrja në aktivitete shkencore, pjesëmarrja në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit, si edhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës	Jetëshkrimi. Dokumente zyrtare për angazhime profesionale. Dokumente, ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë kandidati, Të cilat dëshmojnë angazhimin, ekspertizën dhe ndikimin e angazhimit. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete mbi pjesëmarrje në veprimtari shkencore, të hartimit të legjislacionit dhe në veprimtari të tjera profesionale.	Lloji dhe rëndësia e angazhimeve të tjera profesionale në pesë vitet e fundit. Natyra dhe shkalla e kontributit konkret të dhënë në këto veprimtari, ku vlerësohen, por pa u kufizuar: - prezantimet në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; - pjesëmarrja si përfaqësues, ekspert etj. në organizata ndërkombëtare; - pjesëmarrja në grupe pune dhe kontributet konkrete në nisma të konsultimit dhe procese legjislative për hartimin e legjislacionit ; - konsulenca profesionale të dokumentuara; - pozicione përkatëse si i/e ftuar nderi dhe angazhime të njohura në fushën juridike.	4	
2.MERITAT MORALE			Totali i pikëve	Vlerësimi i kandidatit
			30	
Neni 7/a (2)(c) Vlerësimi për integritetin etik e moral	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit të integritetit etik dhe moral.	Niveli e kërkuar e i pritshëm i shkallës së lartë të zotërimit të integritetit etik dhe të cilësive morale të domosdoshme për	18	



Neni 240 (1)(a) i ligjit nr. 115/2016 Rezultatet e vlerësimit të etikës të kandidatëve gjatë punës, nëse ka. Neni 240 (2)(b) i ligjit nr. 115/2016 Cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi.	Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës. Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore. Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill.	ushtrimin e funksionit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Paraqitja, sjellja, cilësia, besueshmëria, dinjiteti dhe profesionalizmi i treguar gjatë intervistës. Gatishmëria, korrektesa, saktësia dhe cilësia në komunikimet me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe në përgjigjet e parashtruara gjatë zhvillimit të intervistës.		
Neni 240 (2)(a) i ligjit nr. 115/2016 Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve.	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit të integritetit etik dhe moral. Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës. Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore. Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë	Shkalla e vlerësimit profesional, etik, moral dhe qytetar që gëzon figura dhe performanca profesionale dhe jetësore e kandidatit/es në shoqëri, në publik dhe ndërmjet kolegëve. Paraqitja, sjellja, cilësia, besueshmëria, dinjiteti dhe profesionalizmi i treguar gjatë intervistës. Gatishmëria, korrektesa, saktësia dhe cilësia në komunikimet me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe në përgjigjet e parashtruara gjatë intervistës.	10	



	civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione të tjera të aksesueshme publikisht ose dokumente të paraqitura në Këshill.			
Neni 240 (2)(c) i ligjit nr. 115/2016 Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me angazhime në kauza të shoqërisë civile. Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione të tjera të aksesueshme publikisht ose dokumente të paraqitura në Këshill.	Lloji, kohëzgjatja dhe shkalla e angazhimit konkret të kauzat e shoqërisë civile.	2	
3. MERITAT ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE			Totali i pikëve	Vlerësimi i kandidatit
			10	
Neni 240 (3)(a) i ligjit nr. 115/2016 Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur	Parashtrimi me shkrim i platformës dhe vizionit mbi çështje dhe sfida të organizimit dhe administrimit të Gjykatës Kushtetues. Parashtrimi i këtyre argumenteve gjatë intervistës së kandidatit/es.	Cilësia, thellësia dhe origjinaliteti i vlerësimeve dhe objektivave të identifikuar për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të Gjykatës Kushtetuese në ushtrimin e funksioneve që i ngarkon	3	



Neni 240 (3)(b) i ligjit nr. 115/2016 Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore Neni 240 (3)(ç) i ligjit nr. 115/2016 Aftësitë e punës në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale	Jetëshkrimi Intervista Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me aftësitë e treguara në ushtrimin e detyrave në përvoja të mëparshme dhe aktuale për çështje të organizimit dhe administrimit të punëve. Statistika profesionale të lëshuara nga institucionet kompetente.	Kushtetuta dhe ligji. Niveli i aftësive të fituara në përvojat, pozicionet dhe përgjegjësitë e ushtruara për aspektet e administrimit, drejtimit dhe administrimit të punëve. Ecuria dhe arritjet e kandidatit/es në ushtrimin e këtyre detyrave	4	
Neni 240 (3)(c) i ligjit nr. 115/2016 Aftësitë e komunikimit Neni 240 (3)(d) i ligjit nr. 115/2016 Aftësitë e përfaqësimit publik	Jetëshkrimi Intervista Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me aftësitë e treguara në përvoja të mëparshme dhe aktuale për çështje të komunikimit dhe përfaqësimit publik.	Niveli i aftësive të fituara për komunikim dhe përfaqësim publik.	2	



<i>Neni 240 (3)(ç) i ligjit nr. 115/2016</i> Aftësitë e punës në grup dhe në ambiente multidisiplinore dhe/ose multikulturore.	Jetëshkrimi.	Ekspozimi i kandidatit në mjedisin ndërkombëtar dhe multidisiplinar gjatë karrierës.	1	
	Intervista			
	Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional.			
	Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendasen ose ndërkombëtare.			
	Çdo dëshmi tjetër e paraqitur në Këshill.			
TOTALI I PIKËVE PËR RENDITJEN E KANDIDATIT			Totali i Pikëve	Pikëzimi nga KED
			100	

SHTOJCA NR. 2

KRITERET E VLERËSIMIT DHE METODOLOGJIA E PIKËZIMIT TË KANDIDATËVE PËR INSPEKTORË TË LARTË TË DREJTËSISË

1. MERITAT PROFESIONALE			Totali i pikëve	Pikëzimi nga KED-i
			50	
KRITERET KUSHTETUESE DHE LIGJORE TË VLERËSIMIT	BURIMET E VLERËSIMIT (LISTË JOSHTERUESE)	INDIKATORË VLERËSUES PËR PIKËZIMIN (LISTË JOSHTERUESE)	Pikëzimi maksimal i grupit të kriterëve	Pikëzim nga KED-i
A.Historiku arsimor dhe profesional <i>Kushtetuta - neni 147/d(3), ligji nr. 115/2016: neni 240(1)(c), (ç), 240(4)(a), (b) dhe (c)</i>			10	



<u>Historiku arsimor:</u> <i>Neni 240(1)(c) i ligjit nr. 115/2016</i> Rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me ecurinë e kryerjes së studimeve të ndjekura, sipas rastit: - nga institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, - Shkolla e Magistraturës. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete nga institucionet kompetente lidhur me dhënien e titullit akademik.	Niveli i rezultateve të arritura gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik. Lloji, profili dhe tematika të dhënies së titullit akademik. Institucioni arsimor që ka dhënë titullin.	2	
<u>Kualifikime pasuniversitare:</u> <i>Neni 240(1)(ç) i ligjit nr. 115/2016</i> Ecuria në punë dhe pjesëmarrja në trajnime profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit. <i>Neni 240(4)(b) i ligjit nr. 115/2016</i> Kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit. <i>Neni 240(4)(a) i ligjit nr. 115/2016</i> Titujt akademikë	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me pjesëmarrje në: - trajnime dhe kurse profesionale. - kualifikime pasuniversitare dhe trajnime në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës. - studime dhe trajnime afatgjata jashtë vendit.	Vëmendja, angazhimi dhe korrektësia e ndjekjes së veprimtarive që mundësojnë rritjen e shkallës së profesionalizimit në ushtrimin e veprimtarisë profesionale. Institucioni organizues, trajnues dhe lloji i kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve të ndjekura. Angazhimi, korrektësia dhe rezultatet e ndjekjes së studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit. Institucioni arsimor dhe trajnues, lloji i studimeve dhe trajnimeve afatgjata të ndjekura.	5	
<u>Njohja e gjuhëve të huaja:</u> <i>Neni 240(4)(c) i ligjit nr. 115/2016</i> Njohja e gjuhëve të huaja	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me certifikimin ose evidentimin e zotërimit të gjuhëve të huaja. Intervistë dhe mendimi i ekspertit.	Lloji, shkalla e zotërimit dhe institucioni ku është vlerësuar njohja e gjuhës së huaj.	3	



	Botime ose dokumente të përgatitura dhe të dorëzuara nga kandidati në gjuhën përkatëse.			
B.Kualifikimi i përgjithshëm profesional <u>Kushtetuta - neni 147/d(3), ligji nr. 115/2006: neni 240(1)(a)</u>			30	
<u>Kushtetuta - neni 147/d(3)</u> Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet [...] nga radhët e juristëve të spikatur [...]. <u>Neni 240 (1)(a) i ligjit nr. 115/2016</u> Rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon.	Jetëshkrimi Punime dhe dokumente profesionale të kandidatit, të përgatitura në përmbushje të funksioneve dhe veprimtarive profesionale, sipas profilit përkatës, ku përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to: vendime gjyqësore, kërkesa për gjykim, pretenca, padi, parashtrësia të mbrojtjes së çështjes, mjete të kundërshtimit të vendimeve, akte administrative dhe parashtrime në praktika administrative të përgatitura me kontribute nga kandidati, përfaqësime të ndryshme të interesave publike ose private përpara organeve të drejtësisë ose institucioneve brenda apo jashtë vendit, prezantime, artikuj dhe publikime shkencore e profesionale. Dokumente, ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli. Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe	Vlerësimi dhe identifikimi i rezultateve profesionale më të spikatura dhe më të shkëlqyera. Rezultatet e vlerësimit profesional të nxjerrë nga 5 dokumente të paraqitura dhe përzgjedhura nga vetë kandidati si më të përshtatshmet për t'u shqyrtuar, të cilat vlerësohen nga Këshilli në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, për tregues të tillë si: - Origjinaliteti (përfshirë edhe kontrollin e plagjiaturës) dhe/ose impaktin e dokumentit; - Aftësitë analitike; - Aftësitë hulumtuese; - Saktësia dhe konciziteti; - Zhvillimi logjik i koncepteve juridike, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja; - Aftësia për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës, si dhe kurajë profesionale për të treguar dhe argumentuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit; - Aftësia për të referuar dhe trajtuar me efektivitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit e qëllimit të aktit, të praktikës e konsoliduar gjyqësore, praktikës së unifikuar të Gjykatës	30	



	arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendasen ose ndërkombëtare. Statistika profesionale nga institucione kompetente.	së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, asaj të GJEDNJ-së dhe jurisprudencës në tërësi.		
C. Kualifikimi shtesë profesional <i>Kushtetuta - neni 147/d(3); ligji nr. 115/2016: neni 240(1)(b)</i>			10	
<u>Relevanca e eksperiencës profesionale në lidhje me rolin dhe funksionet e ILD-së</u> <i>Neni 240 (1)(b) i ligjit nr. 115/2016</i> Vlerësimi i rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve [...]	Jetëshkrimi Dokumente zyrtare për angazhimin dhe rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. 5 dokumente profesionale që tregojnë fushën e specializimit, krahas cilësisë dhe arritjeve gjatë përvojave të punës, ku mund të përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, edhe dokumentet e përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli.	Rezultatet profesionale vlerësohen nga Këshilli në lidhje me rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij Institucioni. Vlerësimi i njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Lloji dhe kohëzgjatja e angazhimit të posaçëm apo të profilizuar, për fusha konkrete të së drejtës: - në veprimtari të caktuara profesionale; - në funksione institucionale, të lidhura me ushtrimin e profesionit.	7	
<u>Angazhime profesionale shtesë</u> <i>Neni 240, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 115/2016</i> [...] pjesëmarrja në aktivitete shkencore, pjesëmarrja në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit, si edhe çdo angazhim tjetër profesional	Jetëshkrimi. Dokumente zyrtare për angazhime profesionale.	Lloji dhe rëndësia e angazhimeve të tjera profesionale në pesë vitet e fundit. Natyra dhe shkalla e kontributit konkret të dhënë në këto veprimtari, ku vlerësohen,	3	



të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës	Dokumente, ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë kandidati, Të cilat dëshmojnë angazhimin, ekspertizën dhe ndikimin e angazhimit. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete mbi pjesëmarrje në veprimtari shkencore, të hartimit të legjislacionit dhe në veprimtari të tjera profesionale.	por pa u kufizuar: - prezantimet në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; -pjesëmarrja si përfaqësues, ekspert etj. në organizata ndërkombëtare; - pjesëmarrja në grupe pune dhe kontributet konkrete në nisma të konsultimit dhe procese legjislative për hartimin e legjislacionit ; -konsulenca profesionale të dokumentuara; -pozicione përkatëse si i/e ftuar nderi dhe angazhime të <u>njohura në fushën juridike</u>.		
2.MERITAT MORALE			Totali i pikëve	Vlerësimi i kandidatit
			25	
<i>Kushtetuta - neni 147/d(3)</i> Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet [...] nga radhët e juristëve [...] me integritet të lartë moral dhe profesional. <i>Neni 240 (1)(a) i ligjit nr. 115/2016</i> Rezultatet e vlerësimit të etikës të kandidatëve gjatë punës, nëse ka. <i>Neni 240 (2)(b) i ligjit nr. 115/2016</i> Cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi.	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin. Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit të integritetit etik dhe moral. Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës. Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore. Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e	Niveli e kërkuar e i pritshëm i shkallës së lartë të zotërimit të integritetit etik dhe të cilësive morale të domosdoshme për ushtrimin e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Paraqitja, sjellja, cilësia, besueshmëria, dinjiteti dhe profesionalizmi i treguar gjatë intervistës. Gatishmëria, korrektesa, saktësia dhe cilësia në komunikimet me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe në përgjigjet e parashtruara gjatë zhvillimit të intervistës.	15	



	interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill.			
Neni 240 (2)(a) i ligjit nr. 115/2016 Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve.	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit të integritetit etik dhe moral. Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës. Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore. Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione të tjera të aksesueshme publikisht ose dokumente të paraqitura në Këshill.	Shkalla e vlerësimit profesional, etik, moral dhe qytetar që gëzon figura dhe performanca profesionale dhe jetësore e kandidatit/es në shoqëri, në publik dhe ndërmjet kolegëve. Paraqitja, sjellja, cilësia, besueshmëria, dinjiteti dhe profesionalizmi i treguar gjatë intervistës. Gatishmëria, korrektesa, saktësia dhe cilësia në komunikimet me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe në përgjigjet e parashtruara gjatë intervistës.	8	
Neni 240 (2)(c) i ligjit nr. 115/2016 Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me angazhime në kauza të shoqërisë civile.	Lloji, kohëzgjatja dhe shkalla e angazhimit konkret të kauzat e shoqërisë civile.	2	



	Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione të tjera të aksesueshme publikisht ose dokumente të paraqitura në Këshill.			
3. MERITAT ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE			Totali i Pikëve	Vlerësimi i Kandidatit
			25	
<i>Neni 240, pika 3, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016</i> Cilësia e programit dhe e vizionit të paraqitur	Parashtrimi me shkrim i platformës dhe vizionit për mënyrën se si kandidati e kupton rolin e tij/saj në ILD, si edhe sfidat në këtë pozicion dhe masat për t'i kaluar ato. Parashtrimi i këtyre argumenteve gjatë intervistës së kandidatit/es.	Cilësia, thellësia dhe origjinaliteti i vlerësimeve dhe objektivave të identifikuara për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të institucionit të ri kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	8	
<i>Neni 240, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 115/2016</i> Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore	Jetëshkrimi Intervista Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me aftësitë e treguara në ushtrimin e detyrave në përvoja të mëparshme dhe aktuale për çështje të organizimit dhe administrimit të punëve.	Niveli i aftësive të fituara në përvojat, pozicionet dhe përgjegjësitë e ushtruara për aspektet e administrimit, drejtimit dhe administrimit të punëve . Ecuria dhe arritjet e kandidatit/es në ushtrimin e këtyre detyrave	10	



	Statistika profesionale të lëshuara nga institucionet kompetente.			
<i>Neni 240, pika 3, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016</i> Aftësitë e komunikimit <i>Neni 240, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr. 115/2016</i> Aftësitë e përfaqësimit publik	Jetëshkrimi Intervista Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me aftësitë e treguara në përvoja të mëparshme dhe aktuale për çështje të komunikimit dhe përfaqësimit publik	Niveli i aftësive të fituara për komunikim dhe përfaqësim publik.	5	
<i>Neni 240, pika 3, shkronja “ç”, të ligjit nr. 115/2016</i> Aftësitë e punës në grup dhe në ambiente multidisiplinore dhe/ose multikulturale	Jetëshkrimi. Intervista Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare.	Ekspozimi i kandidatit në mjedisin ndërkombëtar dhe multidisiplinar gjatë karrierës.	2	
TOTALI I PIKËVE PËR RENDITJEN E KANDIDATIT			Totali i pikëve	Pikëzimi nga KED-i
			100	

**URDHËR****Nr. 90, datë 2.4.2019****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 12, pika 1, dhe 13, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 7, pika 3 e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:

a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;

b) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në marrëdhënie me të tretët;

c) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;

d) nënshkruan aktet e tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me përjashtim të vendimeve;

e) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën 4 prill 2019 deri më 11 prill 2019.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.

4. Z. Luan Daci nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Natasha Mulaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 420 lekë